

DRAFT RAPORTI I
VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR I
PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË
FUSHË KOSOVËS 2024 - 2032





PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	7
2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	8
2.1. DIREKTIVA PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR E BE-së	8
2.1.1. Procedura e VSM-së.....	8
2.2. DIREKTIVA TË TJERA TË BE-së.....	8
2.3. STRATEGJIA 2020 E BE-së	9
2.4. OBJEKTIVAT ZHVILLIMOR TË MIJËVJEÇARIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA.....	9
2.5. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MJEDISORE	10
2.6. HISTORIKU LEGJISLATIV, ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE.....	11
2.6.1. LIGJI I KOSOVËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR.....	11
2.6.2. LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR	12
2.6.3. PLANET DHE PROGRAMET E TJERA TË RËNDËSISHME.....	12
3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VSM.....	13
3.1. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së	13
4. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE	15
4.1. POZITA GJEOGRAFIKE	15
4.2. VEÇORITË MJEDISORE	15
4.2.1. PEDOLOGJIA – PËRMBAJTJA E DHERAVE	15
4.2.2. GJEOLGJIA DHE TOKAT	16
4.2.3. KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE	17
4.2.4. LARTËSIA MBIDETARE	18
4.2.5. KUSHTET KLIMATIKE	18
4.2.6. BIOGJEOGRAFIA DHE BIODIVERSITETI	19
4.2.7. INFRASTRUKTURA TEKNIKE.....	20
4.2.8. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI	21
4.2.9. FAKTORËT MJEDISOR DHE NIVELET E NDOTJES.....	23
5. PËRMBLEDHJE E PROBLEMEVE MJEDISORE	25
5.1. ZONAT ME PROBLEME MJEDISORE.....	25
5.1.1. ZONAT NË RREZIK TË DEGRADIMIT TË THELLË MJEDISOR.....	25
5.1.2. Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore	26
6. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJËS SË PZHK-së	27
6.1. VIZIONI DHE SKENARËT E ZHVILLIMIT.....	27



6.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHK SIPAS FUSHAVE TEMATIKE.....	28
6.2.1. ZHVILLIMI EKONOMIK.....	28
6.2.2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE.....	29
6.2.3. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI	31
6.2.4. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	32
6.2.5. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI	34
6.2.6. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE.....	35
6.2.7. VENDBANIMET	35
6.2.8. BANIMI SOCIAL.....	35
6.2.9. VENDBANIMET JO FORMALE	35
6.2.10. NDËRTIMET PA LEJE	36
6.2.11. SHFRYTËZIMI I TOKËS.....	36
6.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR	38
6.4. ASPEKTE PËRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE MJEDISORE	40
6.4.1. POPULLSIA DHE SHËNDETI PUBLIK	41
6.4.2. NDIKIMET MJEDISORE TË LIDHURA ME POPULLSINË DHE SHËNDETIM.....	41
6.5. VEÇORITË NATYRORE KRYESORE TË KOMUNËS DHE ZONAT QË NDIKOHEN.....	41
6.6. ZONIMI I TERRITORIT TË KOMUNËS.....	42
6.6.1. ZONAT E NDËRTIMIT NË VENDBANIME:	42
6.7. MJEDISI I NDËRTUAR DHE KULTURA	46
7. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE.....	49
7.1. OBJEKTIVAT E VSM	49
7.2. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNË ZHVILLIMIN KOMUNAL	50
7.3. QËLLIMET STRATEGJIKE.....	51
7.4. PËRMIRËSIMI I MJEDISIT, CILËSIA, OFRIMI I SHËRMBIMEVE, DHE EFIÇENCA E ENERGJISË	53
8. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE.....	55
8.1. METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E SHKALLËS SË NDIKIMEVE	55
8.2. PËRCAKTIMI I INDIKATORËVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT	56
8.3. NIVELI I PËRPUTHSHMËRISË MJEDISORE TË OBJEKTIVAVE TË PLANIT NË FUNKSION TË OBJEKTIVAVE MJEDISORE (OM)	57
8.3.1. Efektet kumulative	59
9. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT.....	60
9.1. KONCEPTET ZHVILLIMORE TË PËRDORIMIT TË TOKËS, QASJA POLICENTRIKE.....	60



9.2. NDRYSHIMET NË KLIMË	61
9.3. CILËSIA E AJRIT	61
9.3.1. Përfitimet nga hapësirat e gjelbra urbane	62
9.4. ENERGJIA E RINOVUESHME	62
9.5. MBROJTJA E TOKËS.....	63
9.6. MBROJTJA E RESURSEVE UJORE	64
9.7. REDUKTIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE	64
9.8. RRITJA E MBROJTJES, MENAXHIMIT DHE RUAJTJES SË QËNDRUESHME TË TË GJITHA PYJEVE DHE GJELBËRIMI I ZONAVE TË DEGRADUARA	65
9.9. MENAXHIMI I MBETURINAVE	65
10. PLANI I MONITORIMIT	66
11. PËRFUNDIME.....	69
12. LITERATURA	71



Lista e tabelave

Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës	15
Tabela 2 Temperatura mesatare vjetore - IHMK	18
Tabela 3 Temperatura maksimale absolute vjetore - IHMK	19
Tabela 4 Temperatura minimale absolute vjetore - IHMK	19
Tabela 5 Shuma mesatare vjetore dhe mujore e të reshurave në mm	19
Tabela 6 Shuma mesatare vjetore dhe mujore e rrezatimit diellor në orë (h)	19
Tabela 7 Vlerat mesatare shumëvjeçare të lagështisë relative në %	19
Tabela 8 Shtypja atmosferike mesatare vjetore dhe mujore	19
Tabela 9 Shpejtësia mesatare e erës sipas muajve dhe vitit	19
Tabela 10 Vlerat mesatare vjetore të parashikuara të parametrave të ajrit 2020-2022, për komunën e Fushë Kosovës - IHMK	24
Tabela 11 Komponentët mjedisore të parapara në raportin e VSM	55
Tabela 12 Analiza e shkallës së ndikimit në komponentët mjedisore	57
Tabela 13 Tabela e përputhshmërisë mjedisore të objektivave të planit bë funksion të OM	59
Tabela 14 Analizë matricore e efekteve kumulative të elementeve të PZHK-së	60
Tabela 15 Plani i Monitorimit Mjedisor	69

Lista e hartave

Harta 1 Formacionet pedologjike	16
Harta 2 Karakteristikat gjeologjike	17
Harta 3 Hipsometria e terrenit dhe lartësitë mbidetare	18
Harta 5 Infrastruktura rrugore	22
Harta 6 Infrastruktura e transportit	23
Harta 7 Koncepti kryesor për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës së Fushë Kosovës	40



Lista e shkurtimeve

VSM – Vlerësimi Strategjik Mjedisor

VNM – Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

BE – Bashkimi Evropian

KB – Kombet e Bashkuara

EC – European Commission

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

MBPZHR – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

IHMK – Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

AMMK – Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

PZHK – Plani Zhvillimor Komunal

KRM – Kompania Regjionale e Mbeturinave

KEDS – Kompania Kosovare për Distribim me Energji Elektrike

KEK – Koorporata Energjetike e Kosovës

IPPC – International Plant Protection Convention

IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike

ITUN – Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura

QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QMF – Qendër e Mjekësisë Familjare

AMF – Ambulancë e Mjekësisë Familjare

OM – Objektiva Mjedisore

GIS – Geographic Information System

SHBO5 – Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit

DSHPM – Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis

DBZHR – Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

DPU – Drejtoria për Planifikim Urban

DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DSHMS – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale



1. HYRJE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për politika, plane dhe programe vlerëson pasojat qysh në fazat e hershme të vendimmarrjes. Gjithashtu VSM është një proces që synon integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe politikave. Koncepti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor vjen nga politikat dhe programet e niveleve më të larta të planifikimit dhe shfrytëzimit të tokës të cilat kanë synime strategjike dhe vizionare dhe për të cilat kërkohet VSM sipas ligjit.

Qëllimi i raportit të VSM për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë Kosovës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si dhe të ofrojë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për menjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e Planit Zhvillimor Komunal.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën 2001/42/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, dhe ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i cili është transpozim i Direktivës 2001/42/EC të Bashkimit Evropian dhe përcakton kushtet, procedurat dhe mënyrën e vlerësimit strategjik të mjedisit për të siguruar mbrojtjen e tij dhe shëndetit të njeriut.

Vlerësimi i strukturuar mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës do të organizohet si vijon:

- Përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor; përshkrimin e vizionit, prioritetëve dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës dhe marrëdhëniet e tij me politikat, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- Përshkrimin e aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimet e pritura në rast të mos zbatimit të planit;
- Përshkrimin e karakteristikave mjedisore të zonave që kanë të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrimin e problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- Përshkrimin e objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrimin e ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;
- Efektet kumulative të komponentëve mjedisore;
- Përshkrimin e masave që parashikohen për të parandalimin, reduktimin dhe/ose lehtësimin e ndikimeve negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit;
- Përmbledhje e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit;
- Përshkrimin e planit të monitorimit dhe raportimit.

Të dhënat dhe informacionet për komunën e Fushë Kosovës janë siguruar nga Komuna dhe drejtoritë përkatëse, nga hulumtime të ndryshme të kryera për këtë komunë, nga Plani Zhvillimor Komunal i vjetër dhe hulumtime tjera nga interneti.

Ky raport i VSM-së është dokumenti i parë i llojit të tij që hartohet për këtë qëllim në këtë komunë, dhe si i tillë besohet se do mundësojë që zhvillimet e ardhshme të jenë në harmoni me legjislacionin vendor të mjedisit, si dhe me direktivat dhe konventat ndërkombëtare.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

2.1. DIREKTIVA PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR E BE-së

Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, u aprovua më 27 Qershor 2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe programeve publike të cilat janë subjekt i përgatitjes dhe/ose miratimit nga një autoritet në nivelin kombëtar, rajonal ose lokal, ose që përgatiten nga një autoritet për miratim përmes procedurave legjislative dhe të cilat kërkojnë nga dispozitat legjislative, rregullatore ose administrative.¹

Një Vlerësim Strategjik Mjedisor është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

Përgatitjen e planeve për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikim të qytetit dhe vendit ose shfrytëzimit të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);

Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lartë, shtetet anëtare duhet të kryejnë një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet kanë mundësi të kenë efekte domethënëse në mjedis. Nëse raste të tilla, nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

2.1.1. Procedura e VSM-së

Raporti i VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Me aprovimin e planit apo programit, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni, si dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme jo të favorshme në fazat e hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

2.2. DIREKTIVA TË TJERA TË BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën e VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën e VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32001L0042>

2.3. STRATEGJIA 2020 E BE-së

Përveç dokumenteve legjislativ të BE-së të përmendura më sipër, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha, është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor, duke qenë se bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioritetëve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet strategjike përfshijnë "zhvillimin e shpejtë, të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës". Janë shtatë nisma të mëdha si: "*Evropa efikase sa ju përket burimeve*" dhe "*Një politikë industriale për epokën e globalizimit*" të lidhura drejtpërdrejtë me çështjet e qëndrueshmërisë. Nisma të tjera si "*Ajenda Digjitale për Evropën*", "*Unioni i Përtëritjeve*", "*Rinia në lëvizje*", "*Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune*" dhe "*Platforma evropiane kundër varfërisë*", gjithashtu kanë një kontribut në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm nëse do të zbatoheshin në mënyrë efikase.

Strategjia gjithashtu përfshin objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t'i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë, siç janë:

- Zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave serrë;
- 20% rritje të shkallës së energjisë nga burime të ripërtëritshme efikase të energjisë.

Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

2.4. OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE TË MIJËVJEÇARIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Kombet e Bashkuara kanë një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës. Edhe pse jo shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), për të siguruar kushte për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në New York për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, ku pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit². Nga shtatë (7) objektivat e kësaj nisme, një nga to i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programeve të vendit dhe kthimi mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme në ujë të pijshëm të sigurt dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetë e së paku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

Edhe pse në këto 15 vitet e fundit është bërë progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi agjendën e zhvillimit të pas-2015, duke vendosur objektivat dhe pikësynimet e reja për 15 vitet e ardhshme. Agjenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë (17) Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) ose Sustainable Development Goals (SDG), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë e plotësojnë atë që OZHM nuk e kanë arritur. Në këtë agjendë të re të zhvillimit, komponenta e mjedisit konsiderohet të ketë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa çështjet mjedisore kanë lidhje me disa probleme kryesore globale duke afektuar të gjitha aktivitetet njerëzore dhe cilësinë e jetës së njeriut. Kjo është arsyeja pse mjedisit i janë dhënë objektiva të posaçme (OZHQ nr. 11, 13 dhe 15) por edhe objektiva të tjera të cilat në thelb përmbajnë aspekte mjedisore. Këto objektiva janë të rëndësishme që të kenë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të mjedisit.

2.5. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MJEDISORE

Konventa e Aarhus-it (25 Qershor 1998), sipas të cilës shteti duhet të garantojë të drejtën e publikut për të pasur informacion për mjedisin, të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe t'i drejtohet trupave gjykues në lidhje me çështjet e mjedisit. Tri shtyllat kryesore të konventës:

- E drejta e publikut për informacion
- E drejta e publikut për pjesëmarrje
- E drejta e publikut për drejtësi

Konventa Espoo përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Po ashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve.

Protokolli i Kievit kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transportin, zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikimin, turizmin, planifikimin e qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Protokolli lejon identifikimin dhe parandalimin e ndikimeve të mundshme mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes duke zhvilluar politika të qëndrueshme të transportit se sa minimizimin e ndikimeve mjedisore në ndërtimin e rrugëve.

Protokolli i Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, kërkon nga palët e tij që të vlerësojnë pasojat e planeve dhe programeve të tyre zyrtare. Protokolli i Kievit ofron një pjesëmarrje të gjerë të publikut në vendimmarrjen e qeverisë në sektorët zhvillimorë. Protokolli i Kievit rëndësi të veçantë i kushton edhe shëndetit njerëzor.

2.6. HISTORIKU LEGJISLATIV, ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE

2.6.1. LIGJI I KOSOVËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR

Ligji nr. 03/L-230 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, ka për qëllim që përmes vlerësimit strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Ligji nënvizon rëndësinë e integritetit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve përkatëse me ndikim domethënës në mjedis, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Ligji përcakton kriteret për përcaktimin e nevojës për VSM, të dhëna mbi përgatitjen e raportit, informacionet që duhet përfshirë, debati publik, etj. Planet dhe programet të cilat duhet t'i nënshtrohen procesit të VSM, nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin e VSM. Ligji është përafuar me Direktivën 2001/42/EC, datë 27 Qershor 2001.³

Përveç, Ligjit Nr. 03/L-230 të Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor janë konsultuar edhe ligjet tjera relevante mjedisore dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e këtij raporti:

- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor
- Ligji nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji nr. 03/L-233 mbi Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, shfuqizuar pjesërisht nga Ligji nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokës
- Ligji nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike
- Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma
- Ligji nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes
- Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, ndryshuar/plotësuar nga Ligji nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina
- Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike
- Ligji nr.08/L-137 për Pyjet
- Ligji nr. 02/L-53 për Gjuetinë
- Ligji nr. 08/L-084 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-53 për Gjuetinë
- Ligji nr. 08/L-074 për Turizmin
- Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
- Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet
- Ligji nr. 08/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2711>



- Ligji 2003/11 për Rugët
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale
- Ligji nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore
- Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, etj.

2.6.2. LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji Nr. 03/L-106), ndërsa në Korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet;
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrjen e palëve të interesuara. PZHK, si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai përfshin periudhën minimale 8 vjeçare dhe planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale brenda komunës. Të gjitha nivelet e planeve duhet të përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për secilin plan obligohet përgatitja e raportit të VSM paralelisht me planin.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën e zhvillimit hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin e zhvillimeve urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmoni me politikën dhe programet nacionale si dhe duke respektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

2.6.3. PLANET DHE PROGRAMET E TJERA TË RËNDËSISHME

Përveç legjisllacionit, raporti i VSM-së duhet të marrë parasysh edhe Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, Strategjinë për Mjedisin dhe Planin e Veprimit në Mjedis, si dhe disa plane, programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VSM

Qëllimi i hartimit të VSM për Planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i planit, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore.

Objektivat:

- Të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit
- Të konsiderojë efektet e planit mbi mjedisin;
- Të identifikojë alternativat më të përshtatshme për mjedisin;
- Të identifikojë dhe parandalojë efektet kumulative;
- Të rrisë performancën e VNM;
- Të identifikojë dhe orientojë procesin lidhur me efektet potenciale negative mbi mjedisin;
- Të ofrojë argumente për justifikimin e projekteve të propozuara;
- Të reduktojë kohën për grumbullimin e informacionit apo për studime paraprake;
- Të integrojë çështjet mjedisore në procesin e vendimmarrjes;
- Të promovojë mbrojtjen e mjedisit;
- Të kontribuojë për një vendimmarrje sa më të mirë;
- Të ndihmojë për një vendimmarrje transparente, përballë interesave të publikut dhe grupeve të interesit.

3.1. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut, të shkaktuara nga zbatimi i planit, programit ose dokumenteve tjera strategjike. Në raportin e VSM përfshihen edhe masat e rekomanduara për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e planit. Për të siguruar efektivitetin e procesit të VSM, është thelbësore që dokumentet strategjike të marrin në konsideratë disa opsione alternative për arritjen e qëllimeve të identikuara. Në këtë rast VSM lejon vendimmarrësit të marrin në konsideratë opsionin më miqësor ndaj mjedisit.

Fazat kryesore të procesit të VSM me bazë mbi praktikatat ndërkombëtare:



SCREENING

- Plani/programi subjekt i VSM

SCOPING

- Çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VSM

DOKUMENTAT/RAPORTI

- Përgatitja e raportit të VSM dhe Projekt Planit/Programit

KONSULTIMI

- Konsultimi me grupet e interesit dhe me publikun

VENDIMARRJA

- Lëshimi i vendimit për planin/programin përfundimtar bazuar në inputet nga hapi i konsultimit

MONITORIMI

- Monitorimi i efekteve mjedisore të planit përfundimtar

Nevojshmëria	Përshkrimi
Përfshirja/qëllimit të VSM-së	Identifikimi i çështjeve që do të përfshihen në studimin e VSM-së do të orientojë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjera mjedisore apo sociale në zonë dhe konservimin e të gjitha asetëve më rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese përbën bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemes së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme të konsiderohen tendencat e mundshme të zhvillimit. Qëllimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi me të mirë të çështjeve kyçe, dhe një identifikimi me të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet përkatëse.
Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse	VSM analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. VSM mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të planit, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve ose planeve të tjera në afërsi të zonës. VSM do të analizojë specifikisht masat adekuate përmirësuese që do të rezultojnë nga plani. Duke konsideruar, bashkërisht, ndikimet dhe raportin benefit/cost të veprimit ose mos veprimit do të analizohen opsionet dhe përzgjidhet ai që rezulton më i miri në planin ekonomik dhe mjedisor.
Hartimi i raportit të VSM-së	Raporti i VSM përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit. Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit.

Adoptimi	Jepet informacion mbi përputhshmërinë e objektivave mjedisor me elementët kyç të planit, të identifikuar paraprakisht. Mos përputhshmëria e objektivave mjedisor me planin nevojitet të rishikohen dhe propozohen ndryshime të mundshme në plan.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisor dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese/zbutëse për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar në këtë studim.

Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës

4. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

4.1. POZITA GJEOGRAFIKE

Fushë Kosova shtrihet në qendër të Rrafshit të Kosovës, me një sipërfaqe prej 84 km². Në lindje kufizohet me Komunën e Prishtinës, në veri me Komunën e Kastriotit, në Jug me Komunën e Graçanicës, ndërsa në perëndim kufizohet me Komunën e Drenasit. Ajo përbëhet prej gjashtëmbëdhjetë (16) vendbanimeve. Gjendet në zonën e kryqëzimit të rrugëve me rëndësi për transport, si ajo hekurudhore që lidhë Fushë-Kosovë - Shkupin e Mitrovicën, që pastaj lidhet me rrugët ndërkombëtare. Po ashtu, ajo ndodhet në kryqëzim të magjistrave të rëndësishme. Në territorin e saj gjendet edhe Aeroporti Civil Ndërkombëtar i Prishtinës. Komuna e Fushë Kosovës përbëhet nga këto njësi kadastrale: Bardh i Madh, Bardh i Vogël, Bresje, Fushë Kosovë, Grabovc i Poshtëm, Harilaç, Henc, Kuzmin, Lismir, Dobrevë e Epërme, Dobrevë e Poshtme, Nakaradë, Pomozotin, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël dhe Vragoli.

4.2. VEÇORITË MJEDISORE

4.2.1. PEDOLOGJIA – PËRMBAJTJA E DHERAVE

Në rajonin e Komunës së Fushë-Kosovës veçohet tipi i dheut aluvial. Fluvisoli (aluviumi) bënë pjesë në klasën e dherave fluviatile dhe fluviogleje. Gjeneza e fluvisolit dhe veçoritë e saj janë të kushtëzuara me drejtimin hidrologjik të lumit dhe materialit natyror, i cili sedimentohet (rëra, zhavorri). Për këtë arsye, profili i fluvisolit karakterizohet me shtresim të theksuar. Pa marrë parasysh që fluvisoli i takon dherave të pazhvilluara, ato zakonisht kanë pjellshmëri të madhe. Në këtë tokë mund të kultivohet plepi, si dhe perimet. Janë dhera të përshtatshme për livadhe. Kjo tokë renditet në klasën e III-të të bonitetit.

Ndër tipat pedologjike të tokave të cilat janë më të përfaqësuara në Komunën e Fushë-Kosovës janë: Vertisol (smonicë), rreth 35%, Fluvisol (aluviale), rreth 27%, Kambike (tokat e kuqe kafeje), rreth 25%. Vertisol (smonicë). Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokave kryesisht shtrihen në fshatrat: Bardh, Lismir, Kuzmin, Vragoli, Dobrevë e Poshtme dhe Henc.

Tokat aluviale (fluvisol)


Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokave, kryesisht shtrihen në fshatrat: Nakër, Lismir, Kuzmin, Vragoli, Bardh i Vogël, Bardh i Madh, Dobrevë e Poshtme dhe në qytetin e Fushë-Kosovës. Vlera mesatare e reaksionit aktiv të tokës (pH në H₂O) mesatarisht është 7.5pH, por ajo luhet në mes pH 6.7-7.8.

Tokat e kuqe - kafeje (kambike)

Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokës janë ato të fshatrave: Gurshkabë, Bardh i Madh, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël. Vlerat e reaksionit aktiv të tokës (pH në H₂O) mesatarisht është 7.06pH, me luhatje nga pH 4.6 deri 8.4.

Klasa e tokës

Tokat i takojnë klasës së tokave argjilore, lymore-ranore-argjilore, lymore-pluhurore-argjilore dhe lymore-argjilore.



Harta 1 Formacionet pedologjike

4.2.2. GJEOLGJIA DHE TOKAT


Komuna e Fushë-Kosovës në aspektin gjeologjik i takon pjesës qendrore të rrethit lindor të Basenit të Kosovës. Baseni është i formuar në shkëmbinj të vjetërsisë-neogjen, me shpërndarje të gjerë të serisë së thëngjillit. Në bazë të kësaj serie neogjene në mënyrë të qartë bëhet ndarja e bazës, shtresa e thëngjillit dhe fundërrina.

Në sajë të bazës mund të veçohen dy (2) horizonte litologjike:

- Horizonti i poshtëm - përbëhet nga rëra, ndërsa
- Horizonti i sipërm - nga rëra argjilore, ngjyrë hiri në të gjelbër.

Shtresa e thëngjillit përbëhet prej linjiteve me shtresa të holla të djerrinës. Shtresa fundërrinore përbëhet nga argjila ngjyrë hiri me grimca vende-vende të gëlqeres. Në pjesë të caktuara të terrenit shtresa

fundrrinore) përmbi shtresën e thëngjillit shtrihet direkt në formimet aluviale. Pjesët sipërfaqësore të terrenit i krijojnë shtresat aluviale. Formësimet aluviale janë të përbëra me argjilë ranoro-pluhurore, me rërë të kokërrimët dhe vende-vende me përmbajtje më të madhe të fraksioneve të zhavorrit.



Harta 2 Karakteristikat gjeologjike

4.2.3. KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE


Territorin e Fushë Kosovës e përshkojnë tri rrjedha lumore: lumi "Sitnicë", i cili gjendet në kufi të rajonit, lumi "Prishtevkë" me rrjedhën e poshtme të saj dhe "Përroi i Njelmët". Karakteristikat e përgjithshme të drejtimit të rrjedhave janë prerja e dobët e lugut dhe inundacioni i rrafshit të gjerë në raport me sasinë e ujit dhe pjerrtësinë e bregut. Për nga gjatësia e rrjedhës dhe sipërfaqes ujëmbledhëse lumi "Sitnicë" është rrjedha më e madhe e lbrit (35.5% sipërfaqes së përgjithshme të ujëmbledhëse dhe 22,4% sasisë rrjedhëse). Karakteristika e shprehur e rrjedhës së Sitnicës është fluktuacioni (luhatja) i madh i nivelit të ujit, kështu që zgjedhja optimale e profilit për rregullimin e shtratit të lumit është e vështirësuar. Profili natyror i shtratit të lumit është mjaft stabil, ndërsa rënia gjatësore e shtratit është e madhe, pa thyerje të shprehura. Valët vërshuese janë më frekuentive në periudhën më të ftohët të vitit. Shtrati i lumit "Sitnicë" ka qenë i rregulluar 5 km në drejtim të rrjedhës prej Fushë-Kosovës kah Obiliqi. Profili i rregulluar ka qenë 160 m i gjerë dhe thellësi 3m. Përqindja e gjerësisë së shtratit të parregulluar përgjatë Fushë Kosovës ka qenë rreth 30m. Lumi "Prishtevkë" është degë e djathtë e lumit "Sitnicë". Pjesa e rregulluar shërben si recipient i ujërave atmosferike për Prishtinën, ku në pjesën më të madhe rrjedh si kanal i mbyllur. Në pjesën më të madhe rreth Fushë Kosovës shtrati është i parregulluar dhe ashtu si është kalon nën rrugën Pejë-Prishtinë. "Përroska e Njelmët" është degë e "Sitnicës" dhe shtrati i saj është në një pjesë (në gjatësi rreth 700m) e

vendosur në tuba të betonit $\varnothing$ 1000mm deri të rruga "Vëllezërit Janković". Kjo rrjedhë është recipient i ujërave atmosferike në hapësirat ku përfshihet edhe "Kompleksi 300 - banesat".

Lumi "Sitnicë", në të gjitha rrjedhat e tij, është i varfër me ujë, në pjesën më të madhe të vitit, në të derdhen ujërat e zeza dhe atmosferike të lokaliteteve të cilat shtrihen përreth lumit. Është i nevojshëm të bëhet pastrimi i ujërave teknologjikë dhe sanitarë, para derdhjes së kanalizimit në shtratin e lumit "Sitnicë".

4.2.4. LARTËSIA MBIDETARE

Lartësia mesatare mbidetare e territorit të kësaj komune është 530–550 m. Relievi është kryesisht fushor që shtrihet rreth lumit Sitnica dhe Drenica, kurse një pjesë e vogël e territorit në perëndim është kodrinoro-malor, që përfshin malin Golesh (Harilaq), Blinishtë (Sllatinë e Madhe) dhe Gospojë (Bardhi i Madh).



Harta 3 Hipsometria e terrenit dhe lartësitë mbidetare

4.2.5. KUSHTET KLIMATIKE

Temperatura e mesme vjetore e ajrit në rajonin e hulumtuar është 11,5°C, muaji më i ftohtë është Janari, me temperaturë mesatare të ajrit rreth 0,2°C, Korriku është më i ngrohti, me temperaturë 21,4°C.

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t ^c	0.2	4.5	6.5	10.9	14.8	18.5	21.4	21.2	18.0	12.0	6.0	4.5	11.54

Tabela 2 Temperatura mesatare vjetore - IHMK



	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t °C	6.5	11.1	14.1	18.2	24.5	23.8	26.4	24.9	21.9	20.6	15.7	10.4	18.17

Tabela 3 Temperatura maksimale absolute vjetore - IHMK

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t °C	-3.6	-4.2	-2.4	-1.9	8.2	10.3	15.6	15.9	10.7	6.1	-1	-2.6	4.25

Tabela 4 Temperatura minimale absolute vjetore - IHMK

Të reshurat - Shuma vjetore e të reshurave në rajon sillet prej 678.2 mm. Lartësia e të reshurave mujore maksimale mesatare është në Gusht, maksimumi sekondar është në Maj, ndërsa minimumi më së shpeshti është në muajin Nëntor.

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
H _{mes.}	11.7	68.6	61.6	49.4	82.2	86.1	25.3	138.1	44.0	60.1	0.9	50.2	56.5

Tabela 5 Shuma mesatare vjetore dhe mujore e të reshurave në mm

Rrezatimi diellor – Shuma vjetore e orëve me diell në rajon sillet rreth 2172.3 orë. Muaji me më së shumti orë me diell është Korriku ndërsa më së paku orë me diell ka në muajin Dhjetor.

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t (h)	90.0	148.0	136.9	239.1	195.0	218.0	305.0	296.9	236.8	171.6	86.7	48.1	181.0

Tabela 6 Shuma mesatare vjetore dhe mujore e rrezatimit diellor në orë (h)

Lagështia relative e ajrit - Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është në intervalin prej 74,75 %, maksimumi është në Dhjetor 88%, ndërsa muaji më i thatë Prilli me 58%.

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	TOT
%	84	74	71	58	71	74	69	76	70	80	82	88	74.75

Tabela 7 Vlerat mesatare shumëvjeçare të lagështisë relative në %

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	TOT
hPa	953.6	945.0	944.7	946.3	947.4	944.0	947.0	945.8	946.7	946.2	953.7	944.2	948

Tabela 8 Shtypja atmosferike mesatare vjetore dhe mujore

Era - Është e kushtëzuar nga faktorët e ndryshëm, kështu që dendësia e drejtimeve të përshkuara dhe shpejtësia kanë karakter lokal të kushtëzuar nga karakteri orografik i vendit. Era më e shpeshtë është ajo verilindore, kurse shpejtësinë mesatare më të madhe e ka era veri-verilindore në muajin Shkurt me 5.0 m/s.

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Drejtimi dominant	VL	V-VL	V-VL	V-VL	V-VL	VP	VL	VL	VL	VL	VL	JL
Shpejtësia mes. (m/s)	2.6	5.0	4.4	3.7	3.7	2.5	3.5	2.6	3.4	3.0	2.1	3.2

Tabela 9 Shpejtësia mesatare e erës sipas muajve dhe vitit

4.2.6. BIOGEOGRAFIA DHE BIODIVERSITETI

Një pjesë e territorit të Komunës së Fushë Kosovës është e mbuluar nga malet, sipërfaqja e gjithmbarshme e tokave pyjore është 1619 ha. Nga kjo sipërfaqe e mbuluar me pyje janë mbi 900 ha të llojeve: pisha e

bardhë, pisha e zezë, hormoqi, bredhi, larq, dugllazion etj.

Komuna e Fushë Kosovës karakterizohet me prezencën e shpendëve shtegtar, si lejleku që ndërton shtrofullat interesante dhe atraktive (fshatrat Henc, Dobrevë e Poshtme, Dobrevë e Epërme, Harilaq dhe rreth liqenit të Hencit). Ligatina e Hencit – Radevës, e krijuar nga bashkimi i rrjedhave ujore të Magurës dhe Vrellës (të cilat janë degë e majtë e lumit Sitnica) prek fshatrat Henc (Fushë Kosovë), Vrellë (Komuna e Lipjanit) dhe Radevën (Komuna e Graçanicës) dhe është shpallur nën mbrojtje si Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve. Si i vetmi ekosistem i këtij lloji në Kosovë (i formuar në mënyrë artificiale për kultivimin e peshkut Krap – *Cyprinus carpio*), karakterizohet me vlera të veçanta natyrore ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike, peizazhore, etj.

Në këtë zonë janë të pranishme mbi 50 lloje të florës vaskulare. Gjithashtu jetojnë një numër i madh i llojeve të faunës së egër, prej tyre numrin më të madh përfaqësojnë shpendët e egra për çka edhe shquhet kjo zonë. Numri i llojeve të shpendëve të konstatuara deri tani është rreth 78, por mendohet se ky numër duhet të jetë shumë më i madh, duke pasur parasysh se asnjëherë deri tani nuk është bërë ndonjë hulumtim sistematik dhe profesional në nivel të dëshiruar. Habitatet natyrore të Ligatinës së Hencit - Radevës me rrethinë ofrojnë vendstrehim për shume lloje të shpendëve, shumë prej tyre lloje të rralla dhe me status të pafavorshëm të ruajtjes tek në dhe Europë.

Vlerat natyrore të komunës së Fushë Kosovës përfaqësohen edhe me vendbanimin e llojit endemik *Forsythia Europaea* (Boshtra), sipërfaqja e tërësishtme e së cilës është 123.54 ha, prej të cilës pjesa më e madhe shtrihet në Fushë Kosovë (51.92 ha), dhe pjesa tjetër në Drenas (38.42 ha) dhe Lipjan (33.2 ha). *Forsythia Europaea* (Boshtra) është bimë drunore-shkurre, endemike dhe relikte terciere e Kosovës dhe Shqipërisë. Ky lloj në Kosovë rritet në zona shkëmbore–serpentinore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre. Lokaliteti i Boshtrës është shpallur zonë e mbrojtur në kategorinë e Monumentit të Mbrojtur të Natyrës.

4.2.7. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Në Fushë Kosovë, **furnizimi me ujë** kryhet kryesisht nga burimet nëntokësore dhe sipërfaqësore, duke përfshirë zonat rurale që furnizohen nga pusët nëntokësore. KRU "Prishtina" sh.a është ofruesi i vetëm i ujit të pijshëm në zonën e Fushë Kosovës, duke ofruar shërbime të ujit të pijshëm për qytetin dhe disa vendbanime të tjera 24 orë në ditë, me përjashtim të rasteve të defekteve ose problemeve tjera teknike. Sistemi i ujit për pije ka një gjatësi prej rreth 176 km, duke përfshirë edhe zonat rurale, dhe përdor materiale të ndryshme si Asbest Cement (AC), PVC, GIZË, HDPE dhe PE-100-RC.

Sa i përket rrjetit të **kanalizimit**, shërbimi aktual ofron shërbime për rreth 80% të popullsisë, me gjatësi totale të rrjetit prej 150 km. Diametrat e gypave të kanalizimit variojnë midis Ø160 dhe Ø600, përdorimi i materialeve si PESN4, PESN8, beton dhe azbest-çimento. Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët, dhe rehabilitimi është planifikuar për të përmirësuar situatën.

Fushë Kosova nuk ka impiant të trajtimit të ujërave për zonën urbane. Ujërat e ndotura të kanalizimit, të patrajtuara, përmes kolektorëve largohen dhe shkarkohen në lumin Sitnica. Megjithatë, është planifikuar që të ndërtohet një Impiant për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) që do të përfshijë zonën urbane dhe zonat rurale periferike. Projekti është në fazën e studimit të fizibilitetit, me parashikimin e fillimit të ndërtimit në vitin 2024.

Zhvillimi i komunës së Fushë Kosovës ka rritur kërkesën për energji. **Furnizimi me energji elektrike** për qytetin dhe fshatrat përmes dy nënstacioneve ekzistuese është nën presion, ku në bazë të analizës së realizuar nga operatori i shpërndarjes KEDS kapacitetet e transformatorëve e kanë tejkaluar limitin e tyre

kritik, po ashtu edhe linjat furnizuese mbingarkohen gjate periudhave te konsumit te lartë.

Në aspektin e **menaxhimit të mbeturinave**, shërbimi është i plotë për ekonomitë familjare dhe pjesërisht për bizneset dhe institucionet publike. Megjithatë, infrastruktura grumbulluese dhe transportuese ka disa sfida, si mungesa e një pikë transferi për grumbullimin e përkohshëm të mbeturinave dhe nevoja për eliminimin e deponive ilegale. Ekzistojnë përpjekje për riciklimin e mbeturinave, me disa iniciativa private dhe publike, si dhe projekte për ndarjen dhe kompostimin e mbeturinave organike për të zvogëluar sasinë e mbeturinave komunale.


Operatori grumbullon mbeturinat e vëllimshme me kërkesë të qytetarëve, por nuk ka një lokacion të caktuar për dorëzimin e tyre, çka shkakton hedhjen e tyre në vende ilegale. Trajtimi i mbeturinave shtazore mbetet i paorganizuar, duke çuar në hedhjen e tyre në vende të papërshtatshme dhe në deponi ilegale. Sektori i ndërtimit është gjithashtu një ndër gjeneruesit kryesor të mbetjeve inerte. Komuna në këtë drejtim nuk e ka menaxhuar situatën në mënyrën më të mirë meqë ende nuk ka ndonjë lokacion për deponimin dhe trajtimin e këtyre mbeturinave. Për rrjedhojë kemi krijimin e deponive ilegale, 86% të të cilave përbëjnë mbeturinat nga ndërtim/demolimi. Nuk ka një sistem të qartë për menaxhimin e mbeturinave të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë mungesën e informacionit për trajtimin e mbeturinave nga sektori privat. Operacionet e disa operatorëve, si grumbullimi dhe trajtimi i vajrave mbeturinë dhe pajisjeve elektrike, janë të licencuara, por ka edhe operatorë të pa licencuar që punojnë paralelisht, duke shtuar sfidat në menaxhimin e mbeturinave.

4.2.8. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

Nëpër territorin e komunës së Fushë Kosovës kalojnë kategoritë më të rëndësishme të rrugëve, duke filluar nga:

- Autoudha "Ibrahim Rugova" (Morinë-Merdare);
- Autoudha "Arbër Xhaferi" (Prishtinë-Shkup);
- Rruga nacionale N9 (Prishtinë-Pejë);
- Rruga rajonale R120 (Lidhja me komunën e Lipjanit – rruga e vjetër e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari").

Megjithatë, infrastruktura rrugore ka disa sfida, duke përfshirë mungesën e kontinuitetit të korsive të trafikut dhe parkimet e pakënaqshme. Mungesa e parkingjeve publike përbën një problematikë për komunën, duke qenë se dy lokacionet ekzistuese janë shumë të vogla për të përballuar kërkesën për parkimit. Në qendër të qytetit, disa hapësira private janë përdorur për parkime me pagesë, duke shtuar sfidat për banorët.




Harta 4 Infrastruktura rrugore

Transporti publik është një kombinim i linjave urbane, urbano-periferike dhe shërbimeve taksi. Megjithatë, shërbimi është i kufizuar dhe nuk plotëson nevojat e komunitetit në mënyrë të mjaftueshme. Ka një linjë të veçantë që lidh qytetin me aeroportin, por kapaciteti i tij është i kufizuar. Sa i përket **qarkullimit të trafikut**, rruga nacionale N9 (rruga «Nënë Tereza») është mjaft e ngarkuar me qarkullim të automjeteve. Në këtë pjesë të rrugës qarkullojnë rreth 58000 automjete/ditë në të dy kahet. për nga struktura e qarkullimit, në përbërjen e qarkullimit dominojnë automjetet e udhëtarëve me rreth 91%, të përcjellur nga automjetet e rënda me 8%, ndërsa autobusët përbëjnë 1% të përbërjes së përgjithshme të qarkullimit.

Pavarësisht intensitetit të lartë të lëvizjes së këmbësorëve, kushtet e sigurisë në trotuare dhe në kalimet e rrugës shpesh janë të pamjaftueshme, në gjendje jo të mire dhe jo funksionale.

Hekurudha ka një rol të rëndësishëm në lidhjen e Fushë Kosovës me qytete të tjera dhe me vendet fqinje. Megjithatë, shfrytëzimi i saj është i vogël, dhe gjendja e infrastrukturës së hekurudhës është e dobët. Projekti i rehabilitimit të rrjetit hekurudhor është në proces për të përmirësuar këtë situatë në të ardhmen.



Harta 5 Infrastruktura e transportit

4.2.9. FAKTORËT MJEDISOR DHE NIVELET E NDOTJES

Komuna e Fushë Kosovës përballet me një sfidë të shumanshme në gjendjen e saj mjedisore, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, zhurmën dhe biodiversitetin. Afërsia me termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" krahas aktiviteteve tjera industriale, përfshirë prodhimin e nikelit, ka çuar në një degradim të ndjeshëm të cilësisë së ajrit. Aktivitetet industriale kanë ndikuar gjithashtu në trupat ujorë, duke ngritur shqetësime për cilësinë e ujit dhe ndotjen e mundshme. Shfrytëzimi i burimeve natyrore, veçanërisht i minierave të linjtit, ka nisur degradimin dhe erozionin e tokës, duke ndikuar në produktivitetin bujqësor dhe ekuilibrin ekologjik. Ndotja akustike nga operacionet industriale dhe flukset qarkulluese shton faktorët stresues mjedisor. Për më tepër, humbja e biodiversitetit është e dukshme si pasojë e shkatërrimit të habitatit, duke ndikuar si në florë ashtu edhe faunë.

Ndotja e ajrit

Gjendja aktuale e ndotjes së ajrit në Komunën e Fushë Kosovës paraqet sfida për shkak të mungesës së monitorimit të drejtpërdrejtë brenda komunës. Të dhënat nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) tregojnë një rritje graduale të përqendrimeve të ndotësve, veçanërisht të PM10, PM2.5, NO2 dhe ozonit (O3). Ndërsa këto shifra bazohen në modelim të shpërndarjes së ndotjes së ajrit në atmosferë, dhe jo në monitorim të drejtpërdrejtë, përpjekjet për të krijuar infrastrukturën lokale të monitorimit të cilësisë së ajrit janë thelbësore për mbledhjen e saktë të të dhënave.

Komuna	Viti	PM10	PM2.5	NO2	O3
Fushë Kosovë	2020	25.7	18.7	15.8	45.9
	2021	26.4	19.3	20	46.3
	2022	27.9	20.3	20.9	49.1

Tabela 10 Vlerat mesatare vjetore të parashikuara të parametrave të ajrit 2020-2022, për komunën e Fushë Kosovës - IHMK

Ndotja e ajrit në komunën e Fushë Kosovës vjen kryesisht si rezultat i termocentraleve, transportit rrugor dhe atij hekurudhor, prej ku specifikisht emetohen dyoksidi i sulfurit (SO_2), oksidet e azotit (NO_x) dhe grimcat e pluhurit (PM10, PM2.5). Operacionet e minierave sipërfaqësore përbëjnë burim të madh të emetimit të partikulateve në ajër.

Ndotja e ujit

Profilin dhe vlerësimin e gjendjes së ujit në komunën e Fushë Kosovës e karakterizojnë një sërë sfidash në fushën e ndotjes së ujrave. Lumenjtë, siç është Sitnica, paraqesin një prej problematikave kryesore të ndotjes në rajon, duke marrë shkarkime të shumta nga ujërat e zeza urbane dhe shkarkimet industriale, veçanërisht nga Prishtevka, kolektor i ujërave të shkarkuara urbane nga Prishtina. Gjithashtu, lumi Graçanka rezulton i ndotur vazhdimisht për shkak të ujërave të minierave dhe shkarkimeve të vendbanimeve. Nivelet e larta të përçueshmërisë elektrike në këtë lum tregojnë për ndikimin e pluhurit të hirit dhe derdhjeve nga deponitë e hirit. Analizat gjithashtu evidentojnë nivele të larta të azotit të nitratit dhe azotit të nitrive në lumin Drenica dhe Sitnica, si dhe nivele të larta të fosforit në lumin Prishtevka, të cilat ndikojnë në varfërimin e oksigjenit dhe e bëjnë ujin të papërshtatshëm për ekosistemet ujore.

Për adresimin e këtyre sfidave, duhen marrë masa gjithëpërfshirëse, duke përfshirë përmirësimin e trajtimit të ujërave të zeza, rregullimin e shkarkimeve industriale, promovimin e praktikave të qëndrueshme të minierave dhe zbatimin e protokolleve strikte të monitorimit të cilësisë së ujit.

Ndotja e tokës

Klasifikimi i Fushë Kosovës si shumë i ndotur për sa i përket sipërfaqes së tokës thekson seriozitetin e çështjes së kontaminimit të tokës. Operacionet minerare, që çojnë në heqjen e shtresës së sipërme të tokës dhe krijimin e tokës djerrë, veçanërisht në Bardh të Madh, kontribuojnë në degradimin e tokës. Për më tepër, prania e deponive ilegale të mbetjeve e bën tokën të pambrojtur ndaj rrjedhjeve të ujit të ndotur. Pavarësisht përgjegjësisë së institucioneve si IHMK, Institutit Bujqësor të Kosovës për monitorimin e cilësisë së tokës, legjislacionit aktual që mandaton vetë-monitorimin nga ndotësit e mundshëm, dhe KEK-ut që kryen monitorimin në divizionet e minierave, deri më tani nuk kemi hasur në të dhëna numerike të aksesueshme në lidhje me nivelet e ndotjes, duke penguar në vlerësimin gjithëpërfshirës të ndotjes së tokës. Adresimi i këtyre sfidave kërkon një qasje të shumanshme, duke përfshirë zbatimin e rregulloreve për depozitimin e mbetjeve, zbatimin e masave adekuate të veshjes dhe mbrojtjes për deponitë e mbetjeve dhe promovimin e praktikave të përgjegjshme të minierave. Përpjekjet e shtuara për monitorim dhe transparenca e informacionit janë thelbësore për të kuptuar nivelet e ndotjes dhe zbutur ndikimet.

Ndotja akustike

Janë disa faktorë të cilët kontribuojnë në luhatjet e niveleve të zhurmës brenda komunës. Afërsia me termocentralet dhe makineritë minerare në zona si Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm rezulton në zhurmë dhe dridhje të dukshme. Lëvizja e vazhdueshme e automjeteve, veçanërisht në zonat urbane,

kontribuon gjithashtu në nivele më të larta të zhurmës. Aktivitetet ekonomike, veçanërisht operacionet industriale, janë kontribues të rëndësishëm në ndotjen akustike. Megjithatë, mungesa e sistemeve gjithëpërfshirëse të matjes së zhurmës paraqet sfida në vlerësimin e saktë të emetimeve të zhurmës.

Sipërfaqet me rrezikshmëri

Erozioni dhe vërshimet janë dy sfidat kryesore për të cilat ka nevojë për masa parandaluese dhe menaxhuese efektive. Në të njëjtën kohë, prania e objekteve industriale dhe shpërndarësve të naftës dhe gazit butan rrisin rreziqet nga zjarret pyjore, duke theksuar domosdoshmërinë e një strategjie të integruar për parandalimin e tyre. Mungesa e të dhënave për fatkeqësitë natyrore pengon vlerësimin e rreziqeve dhe nevojën për të mbledhur të dhëna të sakta dhe relevante për të mbështetur proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes në të ardhmen.

Menaxhimi i mbeturinave

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave ofrohet nga KRM "Pastrimi", duke përfshirë grumbullimin, transportin, dhe transportimin e tyre në deponinë rajonale. Rrjeti i shërbimit është i gjerë dhe ofrohet në të gjitha zonat, duke përfshirë shërbimin derë më derë për zonat urbane dhe peri-urbane. Niveli i gjenerimit të mbeturinave është lartë, duke kërkuar përmirësime në menaxhimin e tyre në burim dhe në infrastrukturën e transportit. Sipas kapaciteteve ekzistuese, mungon infrastruktura për ndarjen e mbeturinave të veçanta, ku si pasojë ato përfundojnë të përziera në kontejnerë dhe përfundojnë në deponi. Gjenerimi i lartë i mbeturinave përbën një shqetësim të madh për mjedisin. Përqindja e mbetjeve nga ndërtim/demolimi është e lartë duke krijuar nevojën për vëmendje të veçantë në menaxhimin e tyre në të ardhmen, ku bashkë me mbetjet shtazore ato mbesin të pa menaxhuara, gjë për të cilën shfaqet nevoja për infrastrukturë dhe menaxhim të integruar. Sa i përket riciklimit, ndodh në bazë vullnetare dhe privat, me disa kompani private që operojnë në komunë. Ekzistojnë iniciativa për riciklim dhe kompostim, megjithatë, informacioni mbi efektivitetin e tyre është i kufizuar.

5. PËRMBLEDHJE E PROBLEMEVE MJEDISORE

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundësitë për përmirësim.

5.1. ZONAT ME PROBLEME MJEDISORE

Ky seksion përfshin një përmbledhje të:

- Zonave që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonave me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilat mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

5.1.1. ZONAT NË RREZIK TË DEGRADIMIT TË THELLË MJEDISOR

Të gjithë lumenjtë dhe përroskat vuajnë degradim dhe ndotje mjedisore të shkaktuar nga depozitimi i vazhdueshëm i mbetjeve të ujërave të ndotura dhe i lëndëve të ngurta, sidomos rrjedhat e poshtme të lumenjve ku ka shakarkime të mëdha të ujërave të zeza nga kanalizimet që hidhen në të. Zonat pranë termocentraleve "Kosova A" dhe "Kosova B", (si miniera sipërfaqësore në Bardh të Madh) përballen me një

nivel të lartë të degradimit mjedisor si pasojë e aktivitetit të divizioneve për prodhimin e energjisë, aktivitetet mihëse ku me largimin e shtresës së sipërme të tokës krijohen palosje të reja të djerrinës duke çuar në degradimin e sipërfaqes së tokës dhe krijimin e peizazheve të reja.

Përreth deponive të djerrinës si dhe deponive të hirit, ekzistojnë gjithashtu shumë deponi ilegale të mbeturinave me mbeturina komunale, mbeturina ndërtimore, mbeturina tjera nga termocentralet, shirita të vjetër gome, hekurishte, etj. Veç kësaj, deponitë e hapura nuk kanë veshje adekuate apo pajisje tjera për mbrojtjen e tokës dhe nuk ka asnjë masë për zvogëlim të ndikimit për të shmangur kontaminimet e derdhjeve të ujërave nga reshjet e vrullshme dhe stuhitë.

Minierat, fabrikat industriale dhe deponitë e mbeturinave po shkaktojnë ndotje të rënda të tokës, ujit dhe ajrit.

Zjarret pyjore dhe rreziqet potenciale për shpërthime në zonat industriale dhe shpërndarës të karburanteve shtojnë rrezikun për ndotje të mëtejshme të mjedisit dhe sigurinë e komunitetit.

5.1.2. Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore

Zonat pranë lumenjve si Sitnica, Prishtevka, Graçanica dhe Drenica janë të veçanta për shkak të ndotjes intensive të ujit. Ndotja e intensifikuar e këtyre lumenjve rrezikon ekosistemet ujore dhe biodiversitetin e tyre. Nivelet e larta të ndotësve kimikë, siç janë fenolet, nitratet, dhe materiet e tjera ndotëse, shkaktojnë presion të madh në këto ekosisteme, duke rrezikuar shëndetin e tyre dhe aftësinë për të mbështetur jetën e shtazëve dhe bimëve.

Toka bujqësore me potencial të lartë dhe burimet ujore nëntokësore përfaqësojnë një pasuri të çmuar mjedisore. Këto zona janë esenciale për prodhimin bujqësor dhe për furnizimin me ujë për pije dhe kultivim të kopshteve dhe fushave. Ndërhyrjet e paplanifikuara, si urbanizimi i pa-kontrolluar dhe praktikrat bujqësore jo-të qëndrueshme, rrezikojnë të shkaktojnë ndryshime të strukturës së tokës dhe ndotje të rëndë të burimeve ujore nëntokësore. Kjo situatë çon në degradimin e cilësisë së tokës dhe në humbjen e habitatit për bimësi dhe shtazë të ekuilibruar natyror.

Gjatë planifikimit të zhvillimeve të ardhshme në PZHK, është shumë e rëndësishme të ruhen zonat e trashëgimisë natyrore për biodiversitetin e zonës, si habitatet kritike për botën bimore dhe shtazore, për rolin jetik në rregullimin e klimës përmes proceseve si sekuestrimi i karbonit dhe menaxhimi i ujit, si dhe mundësitë që ofrojnë për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të kontrolluar.

- Zona e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve (Ligatina e Hencit-Radevës);
- Lokaliteti i Boshtres "Forsythia Europaea" (Monument natyror me karakter botanik);
- Pishat e Sllatinës

Duhet marrë vendime të kujdesshme në lidhje me përdorimin e ardhshëm të tokës në zonat e parapara për vikende/rekreacion si dhe zonat tjera të pazhvilluara rreth vendbanimeve konform kufinjve të propozuar ndërtimor.

Problemet mjedisore të identifikuar lidhur me menaxhimin e mbetjeve, të ngurta apo të lëngëta, si dhe ndotja e ajrit janë të trajtueshme nëse investimet kryhen në kohë dhe në mënyrë efektive. Me këtë plan janë trajtuar:

- furnizimi me ujë;
- menaxhimi i ujërave të zeza;



- trafiku; dhe
- manaxhimi i integruar i mbetjeve

Ekzistojnë ndërkohë edhe legjislacioni dhe politikat përkatëse të cilat po zhvillohen me qëllim që t'u përgjigjen problemeve mjedisore. Potencialisht ekziston problemi i ndotjes dhe i rënies së nivelit të ujërave nëntokësore për shkak të lumenjve të ndotur dhe të degraduar nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, si dhe pompimit të ujërave nëntokësore. Efekti i kësaj ndotjeje dhe i zvogëlimit të ujërave nëntokësore mund të jetë i vështirë për t'u parashikuar dhe riparuar.

Nëse nuk ndalohen ndërtimet pa kritere në zonat e rëndësishme mjedisore, në mënyrë të veçantë, zhvillimi i cili po ndodh në rrethinë të disa vendbanimeve, si në tokat me bonitet të lartë ashtu edhe në zonat kodrinore, ndikon në aspektin biologjik, prishjen e zinxhirit ushqimor, ndërprerjen e korridoreve të rëndësishme për komunikim të ekosistemeve mes vete, si dhe në aspektin peizazhik, rritjen e rrjedhjes sipërfaqësore, gjë e cila mund të përshpejtojë proceset natyrore të erozionit dhe të shkaktojë rrëshqitje të tokës ose përmbytje, sidomos në zonën urbane.

Projektet të cilat janë realizuar më herët, sidomos ato të infrastrukturës rrugore, nuk i janë nënshtruar procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), kështu duke rezultuar në degradim mjedisor, prishje të ashtuquajtura korridore të qarkullimit të shtazëve, vendstrehimit të tyre dhe zhdukjen e disa llojeve nga ky territor.

Në raportet e nivelit qendror, ofrohen në formë të përgjithësuar informata të sektorit shëndetësor në Kosovë, duke vënë në dukje çështje si siguria e ujit të pijshëm dhe siguria rrugore si shqetësime madhore, por në këto raporte nuk trajtohet në mënyrë specifike, ndërkohë që vë në pah edhe natyrën kontradiktore të disa prej treguesve shëndetësorë. Këto raporte që në përmbajtje kanë edhe aspektin mjedisor, mund të shfrytëzohen për të rekomanduar që Qeveria e Kosovës dhe ajo komunale duhet të kalojnë nga ndërhyrjet me karakter kurativ në mjedis dhe shëndetësi, në ato me karakter parandalues.

6. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJËS SË PZHK-së

6.1. VIZIONI DHE SKENARËT E ZHVILLIMIT

Vizioni i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë Kosovës 2024-2032 është:

Fushë Kosova – Komunë e integruar në konceptin e regionit Metropolitan në përmbajtjet kryesore dhe funksionale, me zhvillim të qëndrueshëm brenda trekëndëshit ekonomik të Kosovës, duke zbatuar agjenda e kampanja globale. Një komunë moderne e zhvilluar SMART në të gjitha fushat, infrastrukturë të zhvilluar dhe shërbime cilësore teknike, shëndetësore e publike, me arsim cilësor dhe një mjedis atraktiv për jetesë dhe investime.



6.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHK SIPAS FUSHAVE TEMATIKE

6.2.1. ZHVILLIMI EKONOMIK

QËLLIMI 1	Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe në rritje
Objektivi 1	Shërbime efikase për bizneset të ofruara përmes digjitalizimit
Objektivi 2	Krijimi i një plani strategjik bashkëpunues me komunat fqinje
Objektivi 3	Rregullimi i infrastrukturës teknike dhe tërheqja e investimeve përgjatë rrugës që shpie tek aeroporti ndërkombëtar
QËLLIMI 2	Përmirësimi i infrastrukturës teknike në zonat e korridoreve ekonomike dhe industriale
Objektivi 1	Ofrimi i kushteve teknike të plota në zonat industriale në Fushë Kosovë, si rrjeti rrugor, i telekomunikimit, ujësjellësit dhe kanalizimit
Objektivi 2	Përfundimi i ndërtimit të Parkut Industrial në Dobrevë të Epërme
Objektivi 3	Marketingu i ZE dhe ZI me qëllim zgjerimin e sektorit të industrisë dhe të shërbimeve
Objektivi 4	Krijimi i një plani fiskal të veçantë për investorët industrial në zonat industriale
Objektivi 5	Krijimi i një grupi punues për tërheqjen e IHD-ve
Objektivi 6	Rritja e konkurrencës së eksportit të produkteve komunale
Objektivi 7	Krijimi i data bazës dhe i një web faqeje për ZI dhe ZE ekzistuese dhe atyre të planifikuara
Objektivi 8	Krijimi i një zyreje të veçantë, shërbim një ndalesë për ZE dhe ZI, ku ofrohen dhe kryhen të gjitha shërbimet
QËLLIMI 3	Krijimi i kushteve atraktive për NVM-të
Objektivi 1	Mbështetje e rritjes dhe krijimit të NVM-ve të reja
Objektivi 2	Negociata me banka për të mundësuar uljen e interesit të kredive për bizneset
Objektivi 3	Licencimi online i bizneseve
QËLLIMI 4	Zhvillimi i turizmit përmes mirëmbajtjes së balancit ekologjik dhe ruajtjes së burimeve natyrore
Objektivi 1	Rregullimi i infrastrukturës rrugore dhe hapësinore në zonën e Kalasë së Harilaçit
Objektivi 2	Krijimi dhe organizimi i një festivali të përvitshëm kulturor në Fushë Kosovë që përfshinë komunitetin lokal
Objektivi 3	Nxitja e zhvillimit të gastronomisë përmes organizimit të një festivali të gastronomisë në nivel vendor dhe rajonal
Objektivi 4	Ruajtja dhe promovimi i potencialeve turistike të komunës
Objektivi 5	Krijimi i një data baze numerike dhe hartografike të resurseve kulturore të komunës
Objektivi 6	Krijimi i një sinergjie ndërmjet komunës, sektorit privat dhe OJQ-ve për krijimin e aktiviteteve kulturore-turistike
QËLLIMI 5	Zhvillimi i fuqisë punëtore dhe rritja e punësimit
Objektivi 1	Krijimi i programeve për trajnimin e fuqisë punëtore për ndërmarrësi dhe IT, me fokus të veçantë trajnimin e grave të papuna
Objektivi 2	Krijimi i një grupi punues për Hulumtim dhe Zhvillim brenda institucioneve të komunës
Objektivi 3	Nxitja e orareve fleksibile të punës dhe punëve me gjysmë orari në sektorin publik dhe privat
QËLLIMI 6	Ndërtimtari e qëndrueshme



Objektivi 1	Ngritja e vetëdijesimit të kompanive ndërtimore për përdorimin e materialeve të qëndrueshme dhe zbatimin e standardeve ndërtimore
Objektivi 2	Përkrahja e kompanive private ndërtimore në rregullimin e hapësirave të jashtme duke nxitur gjelbërimin
Objektivi 3	Ofrimi i mundësive të llojllojshme për të mundësuar strehim të përballueshëm dhe që sigurohet lehtësisht nga qytetarët
Objektivi 4	Tërheqja e ndërmarreve prodhuese të materialeve ndërtimore
QËLLIMI 7	Mirëmbajtja e pyjeve përmes menaxhimit të qëndrueshëm
Objektivi 1	Ripyllëzimi i sipërfaqeve pyjore në Harilaq, Bardh të Madh dhe Bellaqec i Vogël
Objektivi 2	Shtimi i ruajtjes së pyjeve nga prerja ilegale
QËLLIMI 8	Krijimi i një rrjeti energjetik dhe hekurudhor efikas dhe të qëndrueshëm në zhvillim ekonomik
Objektivi 1	Përmirësimi i rrjetit energjetik në atë mënyrë që t'i plotësojë nevojat e bizneseve
Objektivi 2	Rritja e investimeve publiko-private për prodhimin e energjisë solare dhe të erës
Objektivi 3	Rritja e kapaciteteve të transportit hekurudhor për mallra
QËLLIMI 9	Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë, prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore në komunën e Fushë Kosovës
Objektivi 1	Zgjerimi dhe modernizimi i kapaciteteve të pikave grumbulluese të pemëve dhe perimeve
Objektivi 2	Përkrahje e fermerëve për kultivim të pemëve dhe perimeve
Objektivi 3	Rritja e fondit blegtoral në vazhdimësi deri 2032
Objektivi 4	Diversifikimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla bujqësore në zonat e thella rurale duke u bazuar në burime lokale deri në vitin 2032
Objektivi 5	Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujitjes për toka bujqësore;
Objektivi 6	Zhvillimi i agro-turizmit në vendet rurale me potencial

6.2.2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Rrjeti i Ujësjellësit dhe Kanalizimit

QËLLIMI 1	Menaxhimi dhe furnizimi i qëndrueshëm i furnizimit me ujë të pijes për zonën urbane dhe rurale (fshatrat), në të mirë të jetës së shëndetshme dhe mirëqenies më të mirë
Objektivi 1	Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë të pijes në të gjithë territorin e komunës deri në vitin 2031
Objektivi 2	Përfundimi i projekteve të ujësjellësit në fshatrat pa ujësjellës, për një shërbim më cilësor të qytetareve të asaj zone deri në vitin 2031
Objektivi 3	Zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues për 5% çdo vit
QËLLIMI 2	Menaxhimi dhe qasje e qëndrueshme në infrastrukturë të ujërave të zeza
Objektivi 1	Parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ujërat e zeza deri në vitin 2028.
Objektivi 2	Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese të kanalizimit deri 2028.
Objektivi 3	Zgjerimi i rrjetit të infrastrukturës të kanalizimit pa rrjet në zona urbane dhe rurale deri 2031.
Objektivi 4	Zgjerimi dhe ri-vitalizmi i rrjetit të kanalizimit atmosferik



Energjia Elektrike

QËLLIMI 1	Furnizimi i sigurtë dhe i qëndrueshëm me energji elektrike.
Objektivi 1	Sigurimi i furnizimi me energji i të gjitha kategorive të konsumatorëve në mbarë territorin e komunës së Fushë Kosovës deri në vitin 2030.
Objektivi 2	Kabllimi-kalimi i rrjetit ajror në rrjet kabllor nëntokësorë-fillimisht në pjesën Urbane të qytetit deri në vitin 2030.
Objektivi 3	Rritja e efikasitetit të energjisë deri në vitin 2030.
QËLLIMI 1	Përmirësimi i cilësisë të ndriçimit publik.
Objektivi 1	Përmirësimi i rrjetit aktual dhe ndërtimi i rrjetit të ri deri në vitin 2030.
Objektivi 2	Ngritja e efikasitetit/eficienca e energjisë në sektorin e ndriçimit publik deri në vitin 2030.

Energjia Ngrohjes

QËLLIMI 1	Ofrimi i shërbimeve të ngrohjes kolektive për qytetin e Fushë Kosovës
Objektivi 1	Shtirja e rrjetit të energjisë së ngrohjes me ko-gjenerim
Objektivi 2	Përdorimi i energjisë së ri-përtrishme për ngrohje

Telekomunikimi

QËLLIMI 1	Infrastruktura e telekomunikimit modern me shërbime efektive, besueshme dhe në kohë
Objektivi 1	Planifikimi për modernizim të pajisjeve dhe shërbimeve telekomunikuese në përputhshmëri me trendet globale të telekomunikimeve
Objektivi 2	Dizajnimi dhe Unifikimi i infrastrukturës telekomunikuese
Objektivi 3	Mbulueshmëria e 100% të zonave në zonat me mbulueshmëri të dobët me rrjet të telekomunikimit deri në vitin 2026

Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

QËLLIMI 1	Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave
Objektivi 1	Krijimi i një baze të dhënash mbi gjenerimin, grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe asgjësimin, si dhe inventarizimi i lokacioneve problematike deri në vitin 2025
Objektivi 2	Ndarja e zonave të menaxhimit të mbeturinave në nën-zona dhe hartimi i programeve për grumbullimin e ndarë deri më 2025
Objektivi 3	Ngritja e stacionit transfer me infrastrukturën e duhur për deponimin e përkohshëm me mundësi për ndarjen e mbeturinave deri më 2026
Objektivi 4	Vazhdimi i implementimit dhe monitorimi i iniciativave për kompostimin e mbetjeve organike deri në vitin 2026, dhe shtirja e infrastrukturës për qëllime riciklimi, qendrave të tjera të kompostimit deri në vitin 2031, e në vazhdimësi
Objektivi 5	Eliminimi dhe rehabilitimi i pikave të vend-depozitimeve ilegale deri në vitin 2024
Objektivi 6	Ngritja dhe funksionalizimi një sistemi për grumbullimin e mbetjeve tjera përpos atyre komunale dhe të amvisërisë (mbeturinat nga ndërtim/demolimi, shtazore, vëllimshme) me ngritjen e pikave të dedikuara për grumbullimin dhe asgjësimin e tyre deri në vitin 2026
Objektivi 7	Mbikëqyrja dhe kontrolli i aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave përmes inspektimit në vazhdimësi

**6.2.3. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI**

QËLLIMI 1 Përmirësimi dhe menaxhimi i infrastrukturës rrugore	
Objektivi 1	Përmirësimi i Nivelit të Shërbimit - arritja e një nivelit të pranueshëm të shërbimit (NSH) për rrjetin rrugor në tërësi.
Objektivi 2	Përmirësimi i kapacitetit në rrugët dhe udhëkryqet e ngarkuara.
Objektivi 3	Largimi i trafikut tranzit nga pjesa qendrore e qytetit përmes rrugëve qarkore/tranzite.
Objektivi 4	Menaxhimi i qarkullimit të trafikut – rirregullimi i fluksit të trafikut përmes rrugëve njëkahëshe
Objektivi 5	Vendosja e teknologjive të përshtatshme të Sistemit të Transportit Inteligjent (ITS) si një mjet për të arritur një menaxhim më të mirë dhe operime të sistemit ekzistues të transportit.
Objektivi 6	Integrimi i dhe kombinimi i formave të ndryshme të transportit duke siguruar një sistem multimodal të transportit.
QËLLIMI 2 Përmirësimi i infrastrukturës dhe rritja e sigurisë për lëvizje të këmbësorëve dhe çiklistëve	
Objektivi 1	Ndërtimi i trotuareve të reja dhe përmirësimi i trotuareve ekzistuese.
Objektivi 2	Krijimin e vendkalimeve të reja, të sigurta dhe të qasshme në të gjithë qytetin.
Objektivi 3	Zhvillimi i një rrjeti të biçikletave që siguron një qasje të përmirësuar në qendër të qytetit, përgjatë rrugës nacionale N9, zonave tregtare dhe qendrave rekreative brenda komunitetit.
Objektivi 4	Zhvillimi i një skeme për përdorim të përbashkët të biçikletave "bike share" dhe vendparkimet e çiklistëve
Objektivi 5	Lidhjen e mirë të këmbësorëve/çiklistëve me transportin publik, parkingjet e automjeteve, taksitë dhe vendparkimet e biçikletave.
QËLLIMI 3 Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të Transportit Publik	
Objektivi 1	Përmirësimi i linjave të autobusëve urban dhe ndërrurban në Fushë Kosovë
Objektivi 2	Krijimi i një skeme të re të rrjetit të autobusëve, e strukturuar në rrjetin primar (që lidhet me qytetin e Prishtinës) dhe sekondar
Objektivi 3	Rialokimi dhe vendosja e pikave të shkëmbimit/ndërrimit ('Pikave të transferimit') të autobusëve që do të lehtësonin një transferim të lehtë dhe pa pengesa ndërmjet shërbimeve të ndryshme të autobusëve si dhe me mënyrat e tjera si çiklizmi dhe udhëtimi me taksì
Objektivi 4	Sistemi i integruar i biletimit për shërbimet e transportit publik
QËLLIMI 4 Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të parkingjeve	
Objektivi 1	Krijimi i skemave të reja të parkimit – sistemi i parkimit me pagesë;
Objektivi 2	Përdorimi i politikave të planifikimit për të kontrolluar numrin/llojin e parkingjeve të reja të automjeteve në tërë qytetin për përdorim publik
Objektivi 3	Krijimi mundësisë për të vënë në funksion sisteme të automatizuara për parkim, duke përfshirë mekanizmat e alokimit të hapësirës dhe pagesës.
QËLLIMI 5 Përmirësimi i sigurisë dhe menaxhimi i trafikut	
Objektivi 1	Përmirësimi i sigurisë në trafik –një qytet më të sigurt për të jetuar dhe punuar
Objektivi 2	Zvogëlimi i numrit të viktimave të aksidenteve rrugore, në veçanti përdoruesit e cënueshëm të rrugës, duke përfshirë përmirësimin e sigurisë së komunitetit.
Objektivi 3	Koordinonimi i çështjeve të sigurisë rrugore me aktet kryesor brenda nivelit lokal dhe Planin



	Strategjik të Sigurisë në nivel qendror.
QËLLIMI 6	Menaxhimi i mobilitetit përmes pajisjeve intelektuale - "MOBILITETI I MENÇUR"
Objektivi 1	Transporti publik i mençur - Sigurimi i alternativave të transportit që janë të arritshme për personat e të gjitha moshave dhe aftësive fizike;
Objektivi 2	Ndriçimi rrugor i mençur;
Objektivi 3	Menaxhimi i mençur i trafikut;
Objektivi 4	Parkim i mençur- Menaxhimi i zgjuar i parkingjeve i mbështetur tek sensorët e parkimit;
Objektivi 5	Zgjidhje e mençur për huazimin e biçikletave;
Objektivi 6	Sigurimi i qasjes së lehtë dhe funksionale për automjetet e urgjencës përgjatë rrugëve dhe destinacioneve kryesore;
Objektivi 7	Qasje efikase dhe të sigurt në / nga / brenda zonave tregtare dhe industriale si për njerëzit ashtu edhe për mallrat.
QËLLIMI 7	Mjedis më të pastër dhe të sigurt
Objektivi 1	Zëvendësimi i modaliteteve të ndryshme të transportit me mjete më të pastërta të transportit, më pak trafik motorik, më shumë transport publik, çiklizëm;
Objektivi 2	Aplikimi i metodave tjera për zvogëlimin e emisioneve si p.sh , pastrimi i rrugëve, shfrytëzimi i karburanteve të pastërta dhe inspektimi i veturave;
Objektivi 3	Hartimin e Planit lokal për mbrojtjen e ajrit nga ndotësit;
Objektivi 4	Ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore.

6.2.4. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

Shëndetësia dhe mirëqena sociale

QËLLIMI 1	Shërbime cilësore shëndetësore me qasje të lehtësuar
Objektivi 1	Krijimi i një Qendre Mjekësore Familjare me rreze të mbulueshmërisë deri në 800m për zonat urbane me mbi 10,000 banorë deri në vitin 2032
Objektivi 2	Krijimi i një Qendre Mjekësore Familjare me rreze të mbulueshmërisë deri në 3,000m për zonat rurale me mbi 10,000 banorë deri në vitin 2032

Arsimi

QËLLIMI 1	Arsim tërë ditë me infrastrukturë bashkëkohore
Objektivi 1	Krijimi i një institucioni publik parashkollor me rreze të mbulueshmërisë deri në 300m në zonat urbane me mbi 2,500 banorë deri në vitin 2032
Objektivi 2	Krijimi i një institucioni publik parashkollor me rreze të mbulueshmërisë deri në 300m në vendbanimet rurale me mbi 2,500 banorë deri në vitin 2032
Objektivi 3	Krijimi i një institucioni publik të Arsimit Fillor dhe të Mesëm të Ultë me rreze të mbulueshmërisë deri në 600m në zonat urbane me mbi 6,000 banorë deri në vitin 2032
Objektivi 4	Krijimi i një institucioni të Arsimit Fillor dhe të Mesëm të Ultë me rreze të mbulueshmërisë deri në 1,900 m për zonat rurale me mbi 6,000 banorë deri në vitin 2032
Objektivi 5	Krijimi i një institucioni të Arsimit të Mesëm të Lartë me rreze të mbulueshmërisë deri në 1,500m në zonat urbane me mbi 12,500 banorë deri në vitin 2032



Objekti 6	Krijimi i një institucioni të Arsimit të Mesëm të Lartë me rreze të mbulueshmërisë deri në 4,700m në zonat rurale me mbi 12,500 banorë deri në vitin 2032
------------------	---

Administratë

QËLLIMI 1	Krijimi i infrastrukturës së administratës efikase për shërbime administrative sa më afër banorëve
Objekti 1	Ngritja e efikasitetit të shërbimeve administrative për 25% deri në vitin 2031

Shërbime sociale

QËLLIMI 1	Ofrimi i shërbimeve përkrahëse për shtresat në nevojë
Objekti 1	Ngritja e kapaciteteve hapësinore përmes sigurimit dhe zhvillimit të parcelave kadastrale prej 0.25 m ² /banor për ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare deri në vitin 2032
Objekti 2	Ngritja e kapaciteteve hapësinore përmes sigurimit dhe zhvillimit të parcelave kadastrale prej 0.20 m ² /banor për ndërtesat e institucioneve të komunitetit deri në vitin 2032

Kulturë rini dhe sport

QËLLIMI 1	Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm për zhvillimin e artit dhe kulturës
Objekti 1	Ngritja e kapaciteteve hapësinore përmes sigurimit dhe zhvillimit të parcelave kadastrale prej 0.45 m ² /banor për ndërtesat e institucioneve kulturore deri në vitin 2032

Hapësira publike

QËLLIMI 1	Sigurimi i sipërfaqes së mjaftueshme për varreza publike
Objekti 1	Rritja e sipërfaqeve të varrezave publike për 30% deri në vitin 2032
QËLLIMI 2	Përmirësimi i mirëqenies përmes hapësirave të hapura publike
Objekti 1	Krijimi i hapësirave të hapura publike me rreze të mbulueshmërisë deri në 800m në zonë urbane deri në vitin 2032
Objekti 2	Krijimi i hapësirave të hapura publike me rreze të mbulueshmërisë deri në 800m në zonë rurale deri në vitin 2032
QËLLIMI 3	Përmirësimi i shëndetit publik përmes hapësirave rekreative
Objekti 1	Krijimi i hapësirave rekreative me rreze të mbulueshmërisë deri në 800m në zonë urbane deri në vitin 2032
Objekti 2	Krijimi i hapësirave rekreative me rreze të mbulueshmërisë deri në 800m në zonë rurale deri në vitin 2032

**6.2.5. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI**

QËLLIMI 1 Mbrojtja dhe menaxhimi i resurseve ujore në territorin e Komunës së Fushë Kosovës	
Objektivi 1	Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore me përmirësimin e sistemit të trajtimit të ujërave të zeza, kontrolli i rrjedhjeve të efluentëve industriale deri më 2025
Objektivi 2	Identifikimi dhe zbatimi i masave të kontrollit të burimeve të lëndës organike në lumin Sitnica deri në vitin 2025
Objektivi 3	Vlerësimi i përmbajtjes së metaleve të rënda dhe komponimeve hidrokarbure në ujërat sipërfaqësore afër burimeve të ndotjes industriale brenda 12 muajve, e në vazhdim
Objektivi 4	Promovimi i praktikave të qëndrueshme të minierave për reduktimin e ndotjes së ujit përmes menaxhimit të përgjegjshëm të mbetjeve, kontrollit të erozionit dhe adaptimit të teknologjive miqësore me mjedisin, për ruajtjen e cilësisë së ujit në zonat ngjitur me operacionet minerare, deri më 2027, e në vazhdimësi
QËLLIMI 2 Përmirësimi dhe ruajtja e cilësisë së ajrit në territorin e Komunës	
Objektivi 1	Përdorimi i burimeve të ripërtrishme të energjisë në zonat me potencial dhe pajisjeve me efikasitet të lartë energjetik në zonat me dendësi dhe konsum më të lartë deri në vitin 2031
Objektivi 2	Krijimi i një sistemi monitorimi automatik të cilësisë së ajrit në kohë reale, brenda 12 muajve të ardhshëm, për të kuptuar përqendrimin mesatar/vjetor të parametrave ndotës dhe ditët me tejkalime
Objektivi 3	Identifikimi dhe kontrolli i burimeve të ndotjes së ajrit, me fokus grimcat PM, hartimi dhe zbatimi i një rregulloreje deri më 2025
Objektivi 4	Promovimi i përdorimit të lëndëve djegëse më të pastra, për ngrohje dhe transport, duke arritur një rritje prej 20% deri më 2025
QËLLIMI 3 Mbrojtja e tokës nga ndotja, adresimi i proceseve që kontribuojnë në degradimin dhe ndotjen e tokës	
Objektivi 1	Adresimi i proceseve degraduese të tokës përfshirë ndikimin e minierave, zbatimin e masave lidhur me këto ndikime deri më 2025
Objektivi 2	Kufizimi i aktiviteteve në zonat e ndjeshme dhe zonave tampon rreth minierave në vazhdimësi
Objektivi 3	Rritja e përpjekjeve për monitorimin periodik të cilësisë së tokës dhe vlerësimi i shkallës së erozionit të tokës në vazhdimësi
QËLLIMI 4 Reduktimi i ndotjes akustike dhe përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të jetës për banorët e Komunës	
Objektivi 1	Hartimi dhe zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Zhurma deri më 2025;
Objektivi 2	Përcaktimi dhe monitorimi i zonave që përbëjnë burim të zhurmës deri më 2025, marrja e masave për uljen e niveleve të zhurmës në zonat e ndjeshme dhe të banuara deri më 2027
QËLLIMI 5 Mbrojtja dhe menaxhimi i situatave nga fatkeqësitë natyrore	
Objektivi 1	Parandalimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe mbrojtje e vazhdueshme e sipërfaqeve të rrezikuara 2031
QËLLIMI 6 Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit dhe pasurive tjera natyrore të komunës	
Objektivi 1	Rritja e numrit të zonave të mbrojtura dhe promovimi i vlerave të tyre natyrore deri më 2028
Objektivi 2	Parandalimi i veprimeve njerëzore që dëmtojnë pasuritë natyrore të komunës (flora, fauna, pyjet)



6.2.6. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE

QËLLIMI 1	Ruajtja dhe konservimi aktiv apo rigjenerimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si pasuri e çmuar territoriale dhe vlerë e përgjithshme
Objektivi 1	Ruajtja, rigjenerimi/konservimi aktiv dhe adaptimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për përdorim bashkëkohor, në funksion zhvillimi të turizmit.
Objektivi 2	Krijimi i sistemit të menaxhimit dhe financimit për përkujdesje dhe rigjenerim të aseteve të trashëgimisë kulturore, natyrore dhe të turizmit
Objektivi 3	Krijimi i sistemit të identifikimit, dokumentimit, informimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore

6.2.7. VENDBANIMET

QËLLIMI 1	Zhvillimi i ekuilibruar mes vendbanimit urban dhe vendbanimeve rurale.
Objektivi 1	Parandalimi i zgjerimit të pakontrolluar të qytetit jashtë kufirit urban deri në vitin 2026.
Objektivi 2	Promovimi i shfrytëzimeve në pajtueshmëri (komerciale, rekreative, etj.) në lagjet ekzistuese dhe të reja për të plotësuar nevojat e banorëve ekzistues dhe të ardhshëm deri në vitin 2026.
QËLLIMI 2	Mbrojtja e karakterit rural hapësinor dhe planifikim për rritje të ekuilibruar të vendbanimeve rurale
Objektivi 1	Parandalimi i fragmentimit të tokave bujqësore dhe pyjore deri në vitin 2026.
Objektivi 2	Zvogëlimi i pabarazisë së shpërndarjes së infrastrukturës dhe shërbimeve publike ndërmjet Qytetit dhe vendbanimeve rurale, si dhe në mes të vendbanimeve rurale deri në vitin 2026.

6.2.8. BANIMI SOCIAL

QËLLIMI 1	Sigurimi i banimit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e tanishme dhe në të ardhmen
Objektivi 1	Renovimi i 30 njësive banesore në Dobrevë të Epërme;
Objektivi 2	Sigurimin e banimit për 60 familje përmes skemës së Bonus Banimit;
Objektivi 3	Ofrimi i ndihmës përmes riparimit të shtëpive ekzistuese për 45 familje,
Objektivi 4	Riorganizimi -Formalizimi i 2 pilot vendbanimeve joformale (lagja 028 dhe 029)

6.2.9. VENDBANIMET JO FORMALE

QËLLIMI 1	Trajtimi i vendbanimit joformal ekzistues dhe parandalimi i paraqitjes së vendbanimeve të tjera joformale;
Objektivi 1	Trajtimi i çështjes pronësore në vendbanimet joformal, deri në vitin 2026;
Objektivi 2	Sigurimi i tokës ndërtimore, për rastet kur eventualisht parashihet zhvendosja e VBJ, për shkak të rrezikshmërisë eventuale.
Objektivi 3	Parandalimi i krijimit të VBJ, përmes avancimit të kontrollit inspektiv të VBJ;

**6.2.10. NDËRTIMET PA LEJE**

QËLLIMI 1	Trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe parandalimi i ndërtimeve të reja pa leje
Objektivi 1	Zhvillimi i fushatës informuese dhe vetëdijësuese për regjistrim dhe trajtim të ndërtimeve pa leje, deri në vitin 2025;
Objektivi 2	Trajtimi i të gjitha ndërtimeve pa leje, konform legjislacionit në fuqi deri në legalizimin përfundimtar (31.12.2025).
Objektivi 3	Me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje i cili ka hyrë në fuqi, është zgjidhur afati për dorëzimin e aplikimeve për legalizim të ndërtimeve pa leje deri më 31 dhjetor 2025. Prandaj, fushatë e vazhdueshme për vetëdijësim të vazhdueshëm dhe nxitje të qytetarëve që në kuadër të afatit të lejuar, të kryhen aplikimet e nevojshme për legalizim të ndërtimeve pa leje edhe pse në afatin e parë, Komuna ka organizuar disa fushata vetëdijësuese, por numri i aplikimeve nuk kishte rezultuar i kënaqshëm.







6.2.11. SHFRYTËZIMI I TOKËS




QËLLIMI 1	Shfrytëzimi efikas i Tokës për një zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe mjedisor
Objektivi 1	Ruajtja e harmonisë mes shfrytëzimit të Tokës për banim dhe shfrytëzimeve të përziera, industrisë, rekreimit dhe institucioneve deri në vitin 2031
Objektivi 2	Zhvillimi i qëndrueshëm i shfrytëzimit të Tokës deri në vitin 2031
QËLLIMI 2	Fushë Kosova komunë me vendbanime kompakte
Objektivi 1	Mbajtja nën kontroll të zhvillimeve të ndërtimit në vendbanimet e shpërndara me theks të veçantë : Dobërdup, Dobrevë e Ulët, Graboc i Poshtëm, Sllatinë e Vogël dhe Pomozotin.
QËLLIMI 3	Shfrytëzimi për banim të qëndrueshëm në komunën e Fushë Kosova
Objektivi 1	Promovimi i ndërtesave eficiente në sipërfaqet për banim, me shfrytëzim të energjisë së ripërtrishme deri në vitin 2031.
Objektivi 2	Zhvillimi i banimit përmes ndërtesave të mençura deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.
Objektivi 3	Zhvillimi i sipërfaqeve të infrastrukturës publike dhe sociale.
Objektivi 4	Zhvillimi i sipërfaqeve të planifikuara për infrastrukturë në shërbim të arsimit, shëndetësisë, institucioneve të mirëqenies sociale, institucione kulturore, administratë, institucione kulturore, hapësira sportive, ndërtesa fetare dhe varreza deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.
QËLLIMI 4	Mbrojtje e sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në kuadër të shfrytëzimit të Tokës
Objektivi 1	Konservimi dhe promovimi i sipërfaqeve me trashëgimi kulturore dhe natyrore deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.
Objektivi 2	Promovimi i sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe ngritja e vetëdijes në mbrojtjen të këtyre sipërfaqeve në funksion të shfrytëzimit të Tokës dhe zhvillimit të turizmit deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.
QËLLIMI 5	Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i sipërfaqeve të Tokës bujqësore
Objektivi 1	Ruajtja dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore në vendbanimet si : Harilaq, Dobrevë e Ulët, Dobrevë e Epërme, Bardh i Madh, deri në vitin 2030.
Objektivi 2	Promovimi dhe zhvillimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore për bujqësi dhe blegtori në fshatrat me lartësi



	të madhe mbidetare deri në vitin 2031
Objekti 3	Shfrytëzimi i sipërfaqeve të tokave bujqësore për zhvillim të bletarisë deri në vitin 2031
QËLLIMI 6	Mbrojtja dhe zhvillimi i sipërfaqeve të Tokës pyjore
Objekti 1	Ruajtja dhe menaxhimi efikas i sipërfaqeve ekzistuese të Tokës pyjore deri në vitin 2031 dhe në vazhdimësi.
Objekti 2	Ripyllëzimi i sipërfaqeve të reja dhe atyre të dëmtuara të Tokës pyjore deri në vitin 2031
QËLLIMI 7	Mbrojtja dhe zhvillimi i sipërfaqeve ujore
Objekti 1	Ruajtja dhe menaxhimi efikas i sipërfaqeve ekzistuese ujore deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.
QËLLIMI 8	Zhvillim i sipërfaqeve të reja për zona komerciale dhe industriale si dhe krijimi i kushteve për hapësira të reja
Objekti 1	Zhvillimi i sipërfaqeve për koridore ekonomike zhvillimore përgjatë rrugës magjistrale M9 dhe Rruga për Dobrevë e Epërme Dëshmori deri në vitin 2030.
Objekti 2	Ruajtja e zonave ekzistuese komerciale dhe industriale deri në vitin 2030.
Objekti 3	Zhvillim i sipërfaqeve me kapacitete për turizëm në funksion të zhvillimit ekonomik.
Objekti 4	Zhvillimi i sipërfaqeve me potencial për zhvillim të turizmit malor, deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.
Objekti 5	Zhvillim i qëndrueshëm i turizmit rural në zonat me potenciale për zhvillime të tilla, deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.
QËLLIMI 9	Krijimi i hapësirave për zgjerim dhe fuqizim të infrastrukturës rrugore
Objekti 1	Krijimi i sipërfaqeve për rrugë të planifikuara në shërbim të një infrastrukture rrugore të qëndrueshme, deri në vitin 2030.
Objekti 2	Mirëmbajtja dhe zhvillimi i koridoreve ekzistuese rrugore deri në vitin 2030.
Objekti 3	Alokimi sipërfaqeve për koridore, për rrugë bujqësore dhe pyjore deri në vitin 2030.


6.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

	SKENARI 1  SKENARI I ZHVILLIMIT POLICENTRIK ËSHTË SKENAR I ZHVILLIMIT NGA PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL 2013- 2023	SKENARI 2  SKENARI I ZHVILLIMIT OPTIMAL ËSHTË SKENAR I ZHVILLIMIT MONOCENTRIK	SKENARI 3  SKENARI I ZHVILLIMIT MAKSIMAL ËSHTË SKENAR I ZHVILLIMIT POLICENTRIK
NYJET 	Koncentrimi i zhvillimit në nyje, bazohet në zhvillim policentrik. Ky skenar propozon plotësimin e rrjetit urban të vendbanimeve (si qendra dytësore) me funksione dhe shërbime si institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale, për furnizimin e fshatrave.	Përdorimi i nyjeve në një skenar monocentrik paraqet formimin e vetëm një nyje/ qendre dhe koncentrim të pjesës më të madhe të zhvillimit në po atë qendër. Nyja kryesore apo qendra sipas këtij skenari është qyteti i Fushë Kosovës si qendër e rendit të lartë, ndërkohë që nyjet tjera/nën-qendrat ekzistuese nuk do trajtohen me prioritet por do mbahen në kufinj të aktual.	Ky skenar bazohet në zhvillimin e zonës urbane të Fushë Kosovës si nyje kryesore dhe 3 nën-qendrave të tjera sekondare: Bardh i Madh, Sllatinë e Vogël dhe Dobrevë e Epërme, të cilat do të shërbejnë si Qendra të Rendit të Mesëm për ofrimin e shërbimeve, infrastrukturës teknike, publike dhe sociale për fshatrat tjerë. Nyjet tjera ekzistuese do trajtohen mjaftueshëm brenda kufinjve aktual.
KORRIDORET 	Ky skenar bazohet në akset që fillojnë nga Fushë Kosova dhe vazhdojnë nëpër qendrat sekondare që kanë tendencë për zhvillim. Si korridor zhvillimor kryesor konsiderohet aksi Fushë Kosovë-Vragoli-Sllatinë, apo ndryshe rruga në drejtim të Pejës.	Korridoret trajtohen si vijat më të rëndësishme të zhvillimit dhe të transportit e të telekomunikacionit, si nyje kryesore për komunën dhe rajonin. Skenari propozon korridoret e zhvillimit ekonomik që shtrihen përgjatë gjithë rrugëve nacionale N-2, të cilat mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm komercial, akomodimin e bizneseve në këto korridore në mënyrë të planifikuar me infrastrukturë të përshtatshme, me zhvillim të korridoreve të reja të planifikuara me kujdes sipas legjislacionit në fuqi.	Ky skenar propozon korridoret e zhvillimit ekonomik që shtrihen përgjatë gjithë rrugëve nacionale N-2, dhe rrugës në drejtim të vendbanimit Dobrevë e Ulët dhe Epërme, të cilat mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm komercial, akomodimin e bizneseve në këto korridore në mënyrë të planifikuar me infrastrukturë të përshtatshme, me zhvillim të korridoreve të reja të planifikuara me kujdes sipas legjislacionit në fuqi.
PLOTËSIM DHE DENDËSIM 	Ky skenar ofron plotësimin dhe dendësimin në zonën urbane dhe në qendrat sekondare, me synim të zhvillimit më të madh në këto zona por edhe në pjesët tjera rurale.	Ky skenar ofron plotësim dhe dendësim vetëm në zonën urbane. Sipas nevojës, plotësimi dhe dendësimi planifikohet edhe në vendbanimet tjera, mirëpo gjithmonë të monitoruara dhe duke i ruajtur zonat bujqësore. Nuk parashihet zgjerim i kufinjve, por plotësimi përmes dendësimit kompakt të tyre.	Ky skenar ofron plotësimin dhe dendësimin në zonën urbane në funksion të kompaktësimit të qytetit. Sipas nevojës, plotësimi dhe dendësimi planifikohet edhe në vendbanimet: Bardh i Madh, Dobrevë e Ulët dhe Dobrevë e Epërme, të definuara si pjesë e konceptit ku synohet zhvillimi kompakt. Në vendbanimet planifikohet plotësimi i kufinjve përmes dendësimit kompakt të

			tyre.
MBAJTJA NËN KONTROLL 	Ky skenar synon kufizimin e zhvillimeve joefikase dhe mban nën kontroll kufinj të definuar ndërtimor të zonës urbane dhe asaj rurale.	Synohet mbajtja nën kontroll e të gjithë kufinjve ndërtimor, qoftë të zonës urbane, qoftë të vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.	Ky skenar synon mbajtjen nën kontroll të të gjithë kufinjve të rinj ndërtimor të zonës urbane dhe asaj rurale, në veçanti në zonat rurale ku densiteti i popullsisë është më i vogël, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim si: Graboc i Poshtëm, pjesa veriore e Sllatinës së Vogël dhe pjesa lindore e Dobërdupit.
MBROJTJA 	Ky skenar mbron resurset e vlefshme natyrore, kulturore, të trashëgimisë e ekonomike në komunën e Fushë Kosovës.	Ky skenar mbron tokën bujqësore, mirëpo në anën tjetër synon edhe mbrojtjen e pasurive tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për t'u shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjatë.	Ky skenar synon mbrojtjen e tokës bujqësore, mirëpo në anën tjetër synon edhe mbrojtjen e pasurive tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për t'u shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjatë.
ZONAT E RITJES 	Ky skenar ofron ri-zhvillimin e zonave ekzistuese me intensitet më të lartë dhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim, në mënyrë që të sigurohet shfrytëzim efikas i tokës.	Ky skenar ofron ri-zhvillim të zonave ekzistuese me intensitet më të lartë, vetëm në një zonë të rritjes edhe atë në qytetin e Fushë Kosovë, por edhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim, për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës, parashihet dendësimi i zonës urbane në zonën jugore.	Ky skenar ofron ri-zhvillim të zonave ekzistuese me intensitet më të lartë, në zonën e rritjes edhe atë në qytetin e Fushë Kosovës, por edhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës, parashihet dendësimin e zonës urbane në pjesën jugore.

Strukturimi i konceptit kryesor të Zhvillimit Hapësinor është bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale dhe integritetit të zhvillimeve të planifikuara. Logjika e zhvillimit hapësinor dhe integrimi i kërkesave të planifikimit hapësinor rrjedhin drejtpërsëdrejti nga vizioni qëllimet dhe objektivat e Komunës së Fushë Kosovës, përmes tërësive të zgjidhjeve të planifikuara, të prezantuara në mënyrë të përgjithshme përmes përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale dhe propozimet zhvillimore për komunën e Fushë Kosovës.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor përcakton bazën kryesore të zhvillimit dhe shfrytëzimit të tokës të paraqitur në hartat tematike të PZHK-së, kushteve dhe masave të HZK-së. Si përmbajtje dhe elemente të trajtuara gjatë analizës së skenarëve dhe të përvetësuar në konceptin kryesor janë nyjet, korridoret, plotësimi dhe dendësimi, mbajtja nën kontroll, mbrojtja, zonat e rritjes të cilat përpos aspektit hapësinor gjatë strukturimit të skenarëve është trajtuar implikimi financiar i zbatimit të secilit element.



Harta 6 Koncepti kryesor për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës së Fushë Kosovës

6.4. ASPEKTE PËRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE MJEDISORE

Diskutimi i të dhënave bazë është të identifikojë gjendjen mjedisore në raport me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë Kosovës. Ndikimet potenciale të zhvillimeve të ardhshme duhen vlerësuar për nga evolucioni i mundshëm, me ose pa implementimin e planit, përmes indikatorëve të gjendur/supozuar sasiore ose cilësore. Në thelb, gjendja mjedisore e komunës karakterizohet nga përshkrimi i receptorëve mjedisorë, në përputhje me kërkesat e Direktivës mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, si: biodiversiteti, popullsia, shëndeti publik, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimatikë, asetet materiale, trashëgimia kulturore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, peizazhi dhe ndërlidhja midis faktorëve të mësipërm.

6.4.1. POPULLSIA DHE SHËNDETI PUBLIK

Ndikimet në shëndetin publik, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë të tilla si ajri, uji apo toka dhe nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial përmes transportit në ujë dhe kontaktit me njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisorë. Dëndësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, mungesa e hapësirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqësimin e parametrave mjedisorë të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Në komunën e Fushë Kosovës, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF (1), QMF (5) dhe AMF (2).

6.4.2. NDIKIMET MJEDISORE TË LIDHURA ME POPULLSINË DHE SHËNDETIM

Më poshtë, janë identifikuar disa ndikime që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Ndertimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe manaxhimi i mbetjeve;
- Rehabilitimi i zonave me ndotje të lartë dhe atyre që janë potencial për ndotje të komponenteve mjedisorë;
- Ruajtja e burimeve të ujit të pishëm nga ndotja;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Promovimi i mobilitetit, ecjes dhe çiklizmit;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore në shëndetin e njeriut.

6.5. VEÇORITË NATYRORE KRYESORE TË KOMUNËS DHE ZONAT QË NDIKOHEN

Te pjesa e gjendjes ekzistuese të komunës janë paraqitur mjaft të dhëna për veçoritë natyrore dhe karakteristikat tjera natyrore. Në vlerësimin e situatës aktuale mjedisore brenda komunës, disa gjetje dhe sfida kryesore kanë dalë nga analiza e modeleve të përdorimit të tokës të përshkruara në Planin Zhvillimor Komunal 2013-2023+, gjetje të cilat nxjerrin në pah ndikimet e zgjerimeve, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe peizazhin e përgjithshëm mjedisor të komunës. Zgjerimi i vazhdueshëm i ndërtimeve në tokë bujqësore përbën një sfidë të dukshme (ku përveç banimit njihen edhe përzjerje aktivitetesh komerciale dhe industrisë së lehtë). Ky trend, i vërejtur veçanërisht në vendbanimet si Dobrevë e Epërme dhe Dobrevë e Ulët, jo vetëm që e ndërlikon konsolidimin e vendbanimeve por gjithashtu ngre shqetësime lidhur me qëndrueshmërinë e përdorimit të tokës dhe sigurinë ushqimore. Balancimi i zgjerimit të zonave të banuara, si në Harilaq, Fushë Kosovë dhe Dobrevë të Epërme, me imperativin për të ruajtur tokat bujqësore paraqet një sfidë kritike, duke ditur rëndësinë e ruajtjes së tyre mes shtrirjes urbane si masë thelbësore për ruajtjen

e biodiversitetit, sigurinë ushqimore dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës. Gjendja aktuale e zgjerimeve të zonave miniera sipërfaqësore dhe komerciale shkon përtej parametrave fillestar të planifikimit, që tregojnë për tendosje të mundshme në resurset natyrore, rritjen e niveleve të ndotjes dhe presion në rritje mbi infrastrukturën dhe shërbimet. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta. Në tërësi, shumëfishimi i zonave ndërtimore ka ndodhur në kurriz të tokës bujqësore, zhdukjes së pyjeve dhe zvogëlimin e një tërësie peizazhi e gjelbërimit.

6.6. ZONIMI I TERRITORIT TË KOMUNËS

Duke u bazuar në tipologjinë e vendbanimeve, popullsinë, infrastrukturën shoqëruese, arkitekturën, gjeomorfologjitë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Fushë Kosovës me PZHK janë trajtuar si më poshtë:

6.6.1. ZONAT E NDËRTIMIT NË VENDBANIME:

Zonat e pazhvilluara me ndërtim

PZHK ka identifikuar dhe trajtuar zonat e pazhvilluara me ndërtim duke i destinuar si tokë bujqësore, tokë pyjore zona të mbrojtura natyrore dhe zona tjera të mbrojtura, zona për infrastrukturë hidrografike dhe infrastrukturë tjetër.

Zonat turistike

PZHK ka identifikuar zonat rekreative turistike (jashtë qendrës urbane) për zhvillimin e turizmit kryesisht eko-turizmit dhe turizmit rural, në Pishat e Sllatinës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të pyjeve gjethegjere në pjesën perëndimore të komunës (Z.K. Harilaq, Z.K. Sllatinë e Madhe, Z.K. Bardh i Madh dhe Z.K. Graboc i Poshtëm) duke lejuar aktivitete të ecjes në natyrë, kampingun dhe rekreacionin.

Zona të mbrojtura

PZHK ka evidentuar gjithashtu asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore nën mbrojtje, si zona karakteristike me vlera të trashëgimisë kulturore, historike, peizazhike, mjedisore e turistike. Këtu janë identifikuar:

- Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve (Ligatina e Hencit-Radevës);
- Lokaliteti i Boshtres "Forsythia Europaea" (Monument natyror me karakter botanik);
- Zona e veçantë e Pishave të Sllatinës.

PZHK identifikon këto zona me qëllim mbrojtjen nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektural apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik. Gjithashtu, sipas hartës së planifikuar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore, PZHK përcakton zonat e brezit mbrojtës.

Zona industriale dhe zonat për zhvillime industriale:

PZHK planifikon disa zona industriale të cilat do zhvillohen aty ku tashmë është krijuar një bërthamë e një zone industriale në komunë ose aty ku vërtet ekzistojnë kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio-ekonomike dhe mjedisore.

Nga projekti "Vlerësimi i Ripërdorimit të Tokës në Minerat e Kosovës" – LURA, sipërfaqet e vlerësuara optimale për prodhimin e energjisë dhe/ose përdorimin e industrisë së lehtë janë integruar si të përshtatshme për zhvillimin e së njëjtës.

Për zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me PZHK, duhet propozuar masa të mbrojtjes së mjedisit. Në hartën e shfrytëzimit të planifikuar të tokës paraqiten zonat industriale të planifikuara bashkë me kufinj të.

Pyllëzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e gjelbërta dhe të pushimit

Shumë nga zonat e gjelbërta, zonat rekreative natyrore, në shumicën e rasteve vihen para shkatërrimit total të tyre, si pasojë prerjeve ilegale, djegieve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe zonat e shkurreve dhe kullosat janë planifikuar në PZHK. Deri tani shumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund të organizohen pushime vikendi apo diçka të ngjajshme.

Esenciale çka PZHK duhet ofruar është sigurimi i korridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin e rrugëve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për këmbësorët dhe bicikletat dhe tampon zonave të zhvillimet industriale dhe tjera të ndjeshme, si dhe rritjen e fondit të gjelbërt në komunë.

Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik

PZHK duhet të identifikojë qartë në hartë sipërfaqet e ekspozuara ndaj erozionit dhe çfarë shkalle të erozionit, nëse kemi erozion shumë të fortë ose të fortë atëherë të merren rreptësisht masa për parandalimin e tyre. Poashtu duhet të tregoj për zonat e vërshimeve dhe masat të cilat duhet të merren për minimizimin e dëmeve.

- Zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hapësirat e banimit duke e precizuar qartë në hartë (pjesa grafike);
- Zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;
- Zhvillimi i pyjeve, hapësirave të gjelbërta, shiritave gjelbërues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në Planet Rregulluese të Hollësishme dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

Biodiversiteti, flora dhe fauna

Komuna e Fushë Kosovës karakterizohet me prezencën e shpendëve shtegtar, si lejleku që ndërton shtrofullat interesante dhe atraktive (fshatrat Henc, Dobrevë e Poshtme, Dobrevë e Epërme, Harilaq dhe rreth liqenit të Hencit). Ligatina e Hencit – Radevës, e krijuar nga bashkimi i rrjedhave ujore të Magurës dhe Vrellës (të cilat janë degë e majtë e lumit Sitnica) prek fshatrat Henc (Fushë Kosovë), Vrellë (Komuna e Lipjanit) dhe Radevën (Komuna e Graçanicës) dhe është shpallur nën mbrojtje si Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve. Si i vetmi ekosistem i këtij lloji në Kosovë (i formuar në mënyrë artificiale për kultivimin e peshkut Krap – *Cyprinus carpio*), karakterizohet me vlera të veçanta natyrore ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike, peizazhore, etj. Në këtë zonë janë të pranishme mbi 50 lloje të florës vaskulare. Gjithashtu jetojnë një numër i madh i llojeve të faunës së egër, prej tyre numrin më të madh përfaqësojnë shpendët e egra për çka edhe shquhet kjo zonë.

Sa i përket llojeve të bimëve, ekziston llojllojshmëri e bimëve, nga ato barishtore njëvjeçare deri te llojet

shumëvjeçare dhe drunore, apo brezat pyjore, kryesisht pjesa më e madhe me lloje gjethegjërë.

Vlerat natyrore të komunës së Fushë Kosovës përfaqësohen edhe me vendbanimin e llojit endemik Forsythia Europaea (Boshtra), sipërfaqja e tërësishme e së cilës është 123.54 ha, prej të cilës pjesa më e madhe shtrihet në Fushë Kosovë (51.92 ha), dhe pjesa tjetër në Drenas (38.42 ha) dhe Lipjan (33.2 ha). Forsythia Europaea (Boshtra) është bimë drunore-shkurre, endemike dhe relikte terciere e Kosovës dhe Shqipërisë. Ky lloj në Kosovë rritet në zona shkëmbore – serpentinore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre.⁴ Lokaliteti i Boshtrës është shpallur zonë e mbrojtur në kategorinë e Monumentit të Mbrojtur të Natyrës.

Biodiversiteti i Komunës së Fushë Kosovës duhet të mbrohet përmes projekteve dhe planeve promovuese dhe forma tjera të mbrojtjes, poashtu duhet pasur parasysh gjatë zbatimit të projekteve infrastrukture dhe ndërtimore, ruajtja e habitateve natyrore të shtazëve dhe bimëve nga zhurma dhe forma tjera të bezdisjes dhe ndotjes.

Çështje mjedisore të lidhura me biodiversitetin, florën e faunën

Çështjet e identifikuar sa i përket menaxhimit të biodiversitetit të komunës së Fushë Kosovës, për zhvillim të mëtejshëm:

Ndotja dhe degradimi i trupave ujqor: Sasia e ulët e oksigjenit të tretur në ujë tregon për një ndotje të rëndë, nivelet e ulëta të të cilit çojnë në uljen e populates së peshqive dhe organizmave tjerë. Tejkallimet e SHBO5 në lumenjtë si Graçanka, Drenica, dhe Prishtevka tregojnë për një ngarkesë të lartë organike në ujë, që çon në uljen e niveleve të oksigjenit të disponueshëm. Tejkallimet në vlerat e azotit të nitrates dhe nitriteve, si dhe në vlerat e fosforit të ortofosfateve dhe fosforit total në lumenjtë si Drenica, Sitnica dhe Prishtevka, tregojnë për ndotjen nga presionet industriale dhe urbane. Nivelet e larta të këtyre parametrave përshpejtojnë rritjen e algave dhe bimëve të tjera në ujë, si dhe situatë e cila çon në ndryshim të ekosistemit akuatik dhe ndryshimin e habitatit natyror.

- Shkatërrimi dhe prerja e pa kontrolluar e pyjeve si ekosisteme më të rëndësishme për bimët dhe kafshët, çon në rritjen e volumit të rrjedhës sipërfaqësore dhe uljen e infiltrimit si pasojë e urbanizimit, duke rritur rrezikun për vërshime dhe erozion;
- Masat për ruajtjen e biodiversitetit dhe balancin ekologjik duhen marrë në konsideratë, qysh në fazat e hershme të planeve të reja zhvillimore;
- Harmonizimi i planeve rregulloreve dhe masave duhet koordinuar me njësi të tjera të qeverisë qendrore me qëllim sigurimin e korridoreve ekologjike të kalimit të shtazëve nga një ekosistem në tjetrin.

Planifikimi i përdorimit të tokës dhe çështje të sigurimit të shërbimeve

Për të vlerësuar tokën si burim natyror i pa rinovueshëm dhe rolin që ka në hapësira banimi, fillimisht po japin definicionin dhe funksionet bazë të saj. Toka përcaktohet si pjesa e sipërme e kores tokësore, veçanërisht komplekse, që luan rol të rëndësishëm në mjedis në zhvillimin social dhe ekonomik të cilat janë vitale për jetën. Direktiva kuadër e tokës (BE) identifikon shtatë funksione bazë të saj të cilat janë:

- Prodhimi i biomasës, përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë;

⁴ Raporti për Gjendjen e Natyrës 2018-2021, AMMK



- Mbajtjen, filtrimin dhe transformimin e ushqyesve, substancave dhe ujit;
- Mbajtëse e biodiversitetit;
- Mjedis fizik dhe kulturor për njerëzit dhe aktivitetet humane;
- Burim materialesh;
- Si depozitë karboni;
- Vend për trashëgiminë gjeologjike dhe arkeologjike.

Situata në komunën e Fushë Kosovës përballon sfida të mëdha në lidhje me planifikimin dhe përdorimin e tokës, veçanërisht në kontekstin e zhvillimeve të pa planifikuara. Ndërtime të këtilla kanë rezultuar në përdorim të pakëndshëm dhe jo të qëndrueshëm të hapësirave tokësore. Për shkak të mungesës së planifikimit të duhur, zhvillimet e pa kontrolluara në vendbanimet kanë intensifikuar problemet në infrastrukturë dhe kanë shkaktuar degradim të mjedisit.

Në kontekstin e infrastrukturës së ujit, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, situata është pothuajse e papërshtatshme. Shumë prej këtyre strukturave tashmë janë të vendosura në tokë me pronësi private, duke e bërë vështirë kontrollin dhe mirëmbajtjen e tyre për shkak të mangësisë së një përcaktimi të qartë për të drejtat e përdorimit të tokës.

Në mungesë të një planifikimi të integruar dhe të vlerësimit të resurseve, aprovimi i projekteve të reja ka ndodhur pa kujdes të mjaftueshëm. Kjo mungesë e planifikimit ka rënduar situatën e infrastrukturës dhe shërbimeve të nevojshme për vendbanimet, që në thelb duhet të sigurohen nga autoriteti komunal. E kombinuar me një kërkesë për infrastrukturë dhe mobilizim të resurseve financiare, kushtet mjedisore në komunë vazhdojnë të jenë një problem, për adresimin e të cilave është e nevojshme të përmirësohet planifikimi urban dhe vlerësim/monitorimi i rregullt i resurseve. Gjithashtu, është e rëndësishme që autoritetet lokale të sigurojnë burime financiare të mjaftueshme për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të mbështetur projektet e nevojshme për të adresuar problemet mjedisore në komunë.

Rritja e presionit urban, mungesa e strategjive të azhornuara zhvillimi dhe planeve urbanistike, kanë çuar në zënien e zonave të gjera për plotësimin e nevojave të banimit/strehimit dhe kanë kufizuar mundësitë për projektimin e hapësirave të gjelbërimit urban duke çuar në degradim të peizazhit urban. Kjo është posaçërisht e vështirë në kontekstin e një qyteti monocentrik si Fushë Kosova, ku banorët përballen me një jetë shumë të dendur urbane të organizuar vetëm rreth një "unaze" të parë apo rreth një qendre urbane kryesore.

Në këtë kontekst, skenari i zhvillimit policentrik që propozon Plani Zhvillimor Komunal për zhvillimin urban është shumë i rëndësishëm, i cili lejon shpërndarjen e zhvillimeve në zona të ndryshme të qytetit, duke lehtësuar presionin në qendrën kryesore dhe duke ndihmuar në ruajtjen e peizazhit urban. Qasja policentrike inkurajon diversitetin urban dhe krijon mundësi për hapësira të gjelbërta të përshtatshme në secilën zonë të qytetit.

Çështje mjedisore që lidhen me përdorimin e tokës

Planifikimi i zonave ndërtimore (kufinj të zgjeruar ndërtimor) nuk duhet prekur sipërfaqe të gjelbërta, përveç në raste të jashtëzakonshme, për të cilat duhet rikompensuar ato.

Duke pasur parasysh keto specifika, ne kapitullin më poshtë paraqiten masa të pershatshme për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra. Për më tepër, paraqiten kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin e ndërtimeve, që përfshijnë kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, kriteret e trashëgimisë kulturore, kriteret peizazhike,

inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Reziqet natyrore në mjedisin fizik

Me rritjen e ndërtimit dhe degradimit të zonave pyjore, rreziku i përmytjeve rritet gjithashtu. Adaptimi dhe zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat, përmirësimi i informacionit dhe reagimi për zbutjen e efekteve të çdo katastrofe natyrore duhet parë me prioritet edhe atë në funksion të:

- Menaxhimit të rrezikut nga katastrofat;
- Forcimit të shërbimeve hidrometeorologjike;
- Caktimit të kodeve të ndërtimit për aktivitetin sizmik;
- Sigurimin e individëve dhe bizneseve nga katastrofat natyrore.

6.7. MJEDISI I NDËRTUAR DHE KULTURA

Cilësia e ajrit

Përmbledhja e gjendjes së cilësisë së ajrit në Komunën e Fushë Kosovës përmes analizës së të dhënave të monitorimit tregon për një situatë komplekse, me implikime në shëndetin publik, mjedisin natyror dhe nevojën për masa të menjëhershme dhe afatgjata për të përmirësuar cilësinë e ajrit. Përgjithësisht, po rëndësisht disa nën-faktorë të cilët kanë ndikim në cilësinë e ajrit:

- Komunikacioni rrugor;
- Rritja e lartë dhe përdorimi i shpeshtë i makinave private;
- Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro I apo II;
- Edhe pse të vjetër gjendja teknike e tyre jo e mirë, duke liruaz gazra dyfish më shumë se normal;
- Gati të gjitha objektet përdorin ngrohje individuale me dru dhe forma tjera të djegies;
- Një pjesë e madhe e tyre punojnë me naftë dhe me plin;
- Djegiet e mbeturinave në deponi të egra;
- Djegiet e pyjeve dhe mbetjeve të biomasës.

Në vitet e fundit, nivelet e grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2.5, si dhe dyoksidi i azotit (NO₂), kanë treguar tendencën e rritjes në nivel lokal. Këto nivele të larta të ndotësve janë të shqetësueshme për shëndetin e qytetarëve dhe për mjedisin natyror, duke paraqitur një rrezik të rëndë për vegjetacionin dhe biodiversitetin. Njëkohësisht analiza e trendeve vjetore dhe mujore të ndotjes së ajrit tregon një përpjekje për zvogëlimin e ndikimit të disa ndotësve kryesorë në komunë, siç janë PM10, PM2.5, NO₂, SO₂, O₃ dhe CO. Kjo përpjekje është e rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve dhe mjedisin.

Për përmbushjen e objektivave drejtë përmirësimit të cilësisë së ajrit, është e nevojshme vazhdimësia e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe analiza e të dhënave për të identifikuar tendencat afatgjata dhe për të adresuar çdo shqetësim të mundshëm në të ardhmen. Gjithashtu, është e rëndësishme të zhvillohen masa për zvogëlimin e emetimeve nga burimet e ndryshme, si automjetet dhe industrinë, dhe për të siguruar që nivelet e ndotësve të mbeten brenda kufijve të pranueshëm të standardit për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Kjo përfshin edhe nevojën për të rritur hapësirat e gjelbra dhe për të investuar në mbrojtjen dhe rikuperimin e zonës së gjelbër në komunë. Në këtë kontekst, planifikimi i veprimtimit afatgjatë



dhe bashkëpunimi i përbashkët lokal dhe qendror janë thelbësore për të arritur qëllimet për cilësinë e ajrit në Komunën e Fushë Kosovës.

Zhurma

Zhurma kontribuon shumë në uljen e cilësisë së jetës së banorëve të qytetit. Në veçanti, ekspozimi i njerëzve ndaj niveleve të zhurmës mbi 65 dB(A) mund të shkaktojë probleme të rënda shëndetësore. Janë disa faktorë që kontribuojnë në ndryshimin e niveleve të zhurmës brenda komunës, duke përfshirë afërsinë me termocentralet dhe makineritë në miniera, veçanërisht në Bardh të Madh dhe Graboc të Poshtëm, si dhe lëvizjen e vazhdueshme të automjeteve (trafiku rrugor) në mjediset urbane. Aktivitetet industriale, si termocentralet dhe minierat, sjellin një shtesë të ndjeshme të zhurmës dhe dridhjes në zonat përreth tyre, duke përfshirë blloqet e banimit. Kjo ndikim i ndjeshëm në pamjen zanore të zonës shkakton shqetësim për banorët. Në përgjithësi, aktivitetet ekonomike dhe trafiku rrugor janë kontribues kryesor në ndotjen akustike në komunë. Megjithatë, mungesa e sistemeve të matjes paraqet një sfidë në vlerësimin e saktë të emetimeve të zhurmës. Direktiva evropiane për zhurmën mjedisore kërkon nga autoritetet vendore të vlerësojnë nivelet e zhurmës në mjedisin e tyre lokal, të përmbushin treguesit e përbashkët të zhurmës dhe të hartojnë plane veprimi për të parandaluar ose zvogëluar efektet e dëmshme të zhurmës mjedisore. Në këtë aspekt, është e nevojshme zhvillimi i strategjive me objektivin kryesor për reduktimin e zhurmës në fushat e mëposhtme:

- Zvogëlimi i densitetit të trafikut; zvogëlimi i përqindjes së mjeteve të rënda të mallrave; ulje e shpejtësive; rinovimi i transportit publik dhe automjeteve (të rënda) të mallrave; ndërrimi i sipërfaqeve të rrugës etj.; shqyrtimi i zhurmës; dritare rezistente ndaj zërit;
- Krijimi i rregulloreve dhe standardeve për aktivitetet industriale që emetojnë zhurmë;
- Investime në sistemet e matjes së nivelit të zhurmës.

Çështjet jo-teknike, qasjet organizative dhe strategjike, janë po aq të rëndësishme:

- Një qasje organizative është thelbësore për integrimin e planifikimit të uljes së zhurmës në proceset aktuale të planifikimit në nivel lokal dhe bashkëpunimin me palët e interesuara dhe publikun brenda një qyteti. Qasja strategjike duhet të synojë në mënyrë ideale lidhjen e politikës lokale të zhurmës me politikat në nivel rajonal, kombëtar dhe të BE-së.

Burimet ujore

Ndotja e ujit në komunën e Fushë Kosovës është një sfidë e rëndësishme për cilësinë dhe shëndetin e burimeve ujore. Prania e lumenjve si Sitnica, i cili është ndër më të ndoturit në Kosovë, sjell me vete shkarkime të shumta nga burime të ndryshme, duke përfshirë ujërat e zeza shtëpiake dhe shkarkimet industriale. Shkalla e ndotjes është shumë e ndryshme, sepse përveç ndotjeve komunale, ndotja vjen edhe nga shumëllojshmëria e proceseve teknologjike të industrisë, që mund t'i ndajmë në 3 grupe: minerale (thërmija argjilore e mineralesh të ndryshme), organike (mbeturina me prejardhje bimore, shtazore dhe ushqimore) dhe bakteriale.

Matjet tregojnë për një ndotje të vazhdueshme, me nivele të ulëta të oksigjenit të tretur dhe nivele të larta të SHBO5, veçanërisht në lumin Sitnica dhe Drenica, me pikën më të ndotur në Vragoli. Graqanka gjithashtu është vazhdimisht e ndotur për shkak të ujërave të minierave dhe shkarkimeve nga



vendbanimet, e cila shfaq një përçueshmëri të lartë elektrike si pasojë e pluhurit të hirit dhe derdhjeve nga deponitë e tij. Nivelet e azotit të nitrarit dhe nitritit tregojnë për cilësi të dobët të ujit në lumin Drenica dhe Sitnica, ndërsa nivelet më të larta të fosforit vlerësohen në lumin Prishtevka, duke kontribuar në varfërimin e oksigjenit dhe bërjen e ujit të papërshtatshëm për jetën ujore. Megjithatë, disa të dhëna mungojnë, si për nivelet e përbërjes fenolike, që mund të jenë prezent nga aktivitetet industriale.

Një nga masat gjithëpërfshirëse që planifikohet në këtë drejtim është përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza, për të cilën në zonën e Fushë Kosovës është planifikuar të ndërtohet Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) ku do të përfshihet zona urbane dhe zonat rurale periferike të Fushë Kosovë. Ky projekt ka kaluar fazën e studimit të fizibilitetit dhe se brenda vitit parashihet të përfundoj edhe projekti kryesorë dhe se sipas planifikimeve fillimi i ndërtimit do të jetë vitit 2024. Përveç kësaj, fokusi duhet të jetë rregullimi i shkarkimeve industriale, duke përmirësuar standardet dhe praktikën e ndërmarrjeve industriale për të zvogëluar ndotjen e ujit. Promovimi i praktikave të qëndrueshme të minierave është gjithashtu një hap kyç për të kufizuar efektet negative në cilësinë e ujit, si përdorimin e teknologjive të pastra dhe strategjitë e trajtimit të mbeturinave.

Prodhiimi i energjisë solare

Përveç mundësive termike për ofrimin e shërbimeve të ngrohjes tjetër mundësi dhe potencial është shfrytëzimi i energjisë së diellit, duke ndërtuar impiante të paneleve solare duke shndërruar energji diellore në energji elektrike dhe ndërlidhjen e saj me infrastrukturë të ngrohjes. Ngrohja me panele solare mund të realizohet në dy mënyra, në mënyrë të organizuar kolektive duke ndërtuar impiante të mëdha me panele solare ku do të ofrohet shërbime në sipërfaqe të mëdha apo numër të madh të ekonomive familjare (lagje apo fshatra të terë), si dhe instalimet e impianteve të vogla apo individuale ku do të shërbeheshin njësit e banimit individual apo kolektiv, praktika të cilat kohëve të fundit janë duke gjetur zbatim të madhe në vendet e zhvilluara por edhe në Kosovë.

PZHK inkurajon fuqimisht përfshirjen e projekteve të energjisë së rinovueshme (teknologjive si panelet diellore) në zhvillimet e reja. Së fundmi janë propozuar zonat për prodhimin e energjisë solare sipas një projekti të "Vlerësimi i Ripërdorimit të Tokës në Minerat e Kosovës" – LURA, të cilat përfshijnë Z.K. Fushë Kosovë, Dobërdup, Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm. Zonat e planifikuara për prodhimin e energjisë solare, për nga shfrytëzimi aktual i tokës kemi të bëjmë me zona të minierave sipërfaqësore, deponi të hirit, tokë djerrë, me ndjeshmëri të ulët të tokës, që lë të kuptojë se aktiviteti nuk ndikon në zonat kryesore bujqësore apo zonat me ndjeshmëri ekologjike. Projekti nuk pritet të ndikojë në fenomenin e fragmentimit të zonave dhe ekosistemeve dhe nuk pengon rrugët qarkulluese të kafshëve të egra dhe korridoret e habitateve.

Gjithashtu vlen të ceket që këto zona, si toka jo të punueshme dhe jo produktive mbeten zgjedhje ideale për instalimin e paneleve, pra nuk do të ketë ndikime në humbjen e produktivitetit siç do të ndodhte në tokat kulturë.

7. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE

7.1. OBJEKTIVAT E VSM

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë PZHK-së së Komunës së Fushë Kosovës, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Objektivat mjedisore qëndrojnë po njëllor për planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Vlerësimi realizohet për secilën nga Objektivat Mjedisore të listuara si më poshtë:

Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë (p.sh., duke promovuar çiklizmin dhe përmbushja e standardeve të Bashkimit Evropian);

Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji: Përmirësimi, ruajtja e cilësisë së ujit, zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin, përmirësimi ruajtja e aftësisë për të deponuar ujin, minimizimi i përdorimit të panevojshëm të ujit;

Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës, parandalimi i erozionit të tokës, ruajtja e kapacitetit prodhues të tokës (kullsave);

Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, veçanërisht specieve endemike dhe endemorelikte të rralla dhe të kërcënuara;

Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit pyjor, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike;

Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet: Rivitalizimi i ekosistemeve dhe peizazheve të prekura nga aktivitetet njerëzore, ruajtja e karakteristikave të dallueshme të peizazhit dhe pamjeve, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale;

Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike: Ndërtimi i infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike, reduktimi i emetimeve të gazrave sere duke promovuar mobilitetin urban, çiklizmin dhe ecjen;

Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore: Konservimi e restaurimi, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale;

Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Shëndeti: Përmirësimi i shëndetit të popullatës njerëzore, garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore dhe ulja e ekspozimit ndaj rrezikut natyror;

Objektivi Mjedisor 10 (QM10) – Social-ekonomik: Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe ekonomike të komunitetit në përputhje me qëllimet e mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë zhvillimin e projekteve dhe politikave të qëndrueshme, rritjen e përfitimeve të komunitetit nga burimet natyrore, dhe promovimin e përdorimit të teknologjive mjedisore në prodhim dhe konsum;



Objektivat e mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë (ritjen e sigurisë, ofrimin e mundësive për mënyrë aktive jetese, shtimin i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimin i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, PZHK duhet të zbatojë disa parime dhe modele zhvillimi të pranuar gjerësisht, si psh. Komuna e Fushë Kosovës, komunë policentrike, ku qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhetojë për të siguruar shërbimet veç në qendrën administrative.

7.2. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNË ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe pjesë të caktuara të qytetit.

Parimet e përgjithshme të planifikimit hapësinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen si më poshtë:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve dhe komunikimin e habitateve mes veti;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe përgatitjen e sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të PZHK-së, parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufinjve të planifikuar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më efektiv të tokës;
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve– akses i ndërmjet vendbanimeve dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;



- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Rizhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllëzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore – historike dhe natyrore;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

7.3. QËLLIMET STRATEGJIKE

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva globale dhe në objektiva të nivelit lokal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

- Zhvillimi i përmirësuar, ku të gjithë aktorët kanë të drejtën për informacion, të dëgjohen, të ndikojnë dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes, me ndikim në jetën dhe të ardhmen e tyre. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, zhdukjen e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;
- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj.);
- Zhvillimi i partneritetit global për zhvillim.

Qëllimet strategjike të mësipërme synojnë të sigurojnë pjesëmarrje të përfshirë dhe të drejtën për informim për të gjithë aktorët e interesuar, duke i lejuar ata të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe të kenë rol aktiv në përcaktimin e të ardhmes së tyre. Fokus në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe ndryshime në strukturën sociale dhe ekonomike, duke përfshirë zhvillimin e barabartë në nivel komunal për të siguruar të ardhme të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë banorët.

Qëllimet hartohen në përpjekje për të krijuar kushte për përmbushjen e nevojave themelore duke garantuar qasje të barabartë në shërbimet dhe burimet e nevojshme. Gjithashtu ato ofrojnë përpjekje për sigurimin e arsimit bazë, sigurinë sociale dhe fizike si dhe sigurinë e mjedisit për të garantuar një mjedis të qetë dhe të sigurt.

PZHK parashikon një qasje integrale për zhvillimin e komunës si tërësi, duke përfshirë vendbanimet, lagjet dhe zonat e vogla të banimit brenda kufinjve të komunës. Si një dokument planifikimi, PZHK përcakton kufinjte, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standardet e nevojshme për të gjithë territorin e komunës, pas analizës dhe identifikimit të nevojave dhe karakteristikave të secilit prej vendbanimeve.



Duke qenë se PZHK fokusohet në përcaktimin e një strategjie të përgjithshme dhe standardeve të përbashkëta për zhvillimin në tërësinë e komunës, në këtë pikë, hartohen Planet Rregulluese të Hollësishme, të cilat specifikojnë detajet e nevojshme për secilën zonë banimi, udhëzime dhe rregulla të detajuara për përdorimin e tokës, intensitetin e ndërtimit, karakteristikat arkitektonike dhe aspekte të tjera nevojshme për zhvillimin e planifikuar të zonave të banimit.

PZHK synon të përmbushë konceptin e menaxhimit të pronës në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë pronarët, pa dallim, përfshirë këtu zonat e reja të ndërtimit, zonat industriale dhe të gjelbra, dhe të gjitha aspektet e zhvillimit të infrastrukturës. Megjithatë, në analizën tonë, sfiduese është mungesa e specifikimeve të detajuara për këto zona, duke përfshirë ndikimin e tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve dhe ekosistemet natyrore. Nëse janë marrë masa për të siguruar qarkullim natyror të shtazëve dhe mbrojtjen e llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, si dhe për të adresuar pyllëzimin, rypyllëzimin, dhe krijimin e hapësirave të gjelbra dhe të zonave rekreative.

Si konkludim, për përmbushjen e qëllimeve strategjike të përcaktuara, duhen zbatuar parime dhe modele zhvillimore të pranura gjerësisht, duke u përqendruar në qasjen policentrike, ashtu siç edhe propozohet zhvillimi i ardhshëm i Fushë Kosovës. Ky model planifikimi, ndihmon në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve komunale, duke u fokusuar në përdorimin e burimeve në një mënyrë më të zgjuar dhe të koordinuar. Përveç kësaj, qasja policentrike ul koston e infrastrukturës dhe e bën aksesin më të lehtë për banorët në shërbimet e tyre rutinë. Gjithashtu, kjo qasje promovon përdorimin e mjeteve alternative të transportit, duke reduktuar ndotjen dhe ndikimin e trafikut në mjedis. Modeli i propozuar për zhvillimin e ardhshëm të Fushë Kosovës përbën një shembull konkret të përdorimit të kësaj qasjeje në praktikë, duke demonstruar suksesin dhe avantazhet e një planifikimi urban të përqendruar dhe të integruar.

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e planit mund të përmbledhen si më poshtë:

- Pakësimi i sasisë së mbetjeve dhe manaxhimi i integruar i tyre;
- Krijimi i një komune të qëndrueshme dhe të shëndetshme;
- Identifikimi dhe krijimi i habitateve të reja, dhe korridoreve të gjelbër;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave;
- Kursimi i energjisë dhe pakësimi i emisioneve të gazeve serrë;
- Cilësia e ujërave sipërfaqësore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivës Komizë për Ujërat nga BE;
- Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me biçikleta;
- Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë ato arkeologjike dhe arkitekturore;
- Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhike;
- Mbrojtja e mjedisit natyror në zonat pyjore dhe malore;
- Ripërdorimi i tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

Pikat e forta të strategjisë së zhvillimit

Në qendër të strategjisë është një ndryshim në fokusin e zhvillimit të komunës, i cili merr parasysh përveç zhvillimit ekonomik, edhe aspekte të tjera të zhvillimit si organizimin e territorit, zhvillimin e qëndrueshëm, identitetin kulturor dhe proceset demokratike. Planit përcakton strategji të qarta dhe të lidhura me plane konkrete veprimi për të siguruar zbatim të qëndrueshëm të planit. Gjithashtu inkurajon një përfshirje të gjerë të palëve të interesuara dhe përdor proces të hapur dhe të përfshirë gjatë konsultimeve publike, ku identifikon sfidat që ndeshet komuniteti dhe metodat për t'u përgjigjur këtyre sfidave si dhe mbështet dhe strukturon dialogun ndërmjet palëve dhe ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve të bazuara në konsensus.

Strategjia e planifikimit do të shërbejë si një mjet për manaxhimin e ndryshimeve që ndihmon në përcaktimin e përparësive dhe përmirëson përgjigjen institucionale dhe atë vendimmarrëse. Sa i përket nevojës për rritjen/zgjerimin e shërbimeve plani:

- Ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve dhe integrimin e vendbanimeve formale dhe informale në një sistem të përbashkët;
- Ndihmon për të identifikuar kërkesën për shërbim dhe burime;
- Integron aspektet sociale, mjedisore, ekonomike, institucionale dhe kulturore;
- Njeh pasuri të prekshme dhe të paprekshme kulturore që i shtojnë vlerën e cilësisë së jetës;
- Ndërton mundësi për tendencat e reja dhe potencialin krijues;
- Vendos çështjet mjedisore si prioritet i zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit;
- Shërben si një platformë për zhvillimin e koncepteve dhe modeleve të reja të qëndrueshme të strehimit, energjisë dhe transportit;
- Ofron instrumente fleksibile që autoritet t'i përgjigjen shpejtë fatkeqësive të mundshme natyrore.

7.4. PËRMIRËSIMI I MJEDISIT, CILËSIA, OFRIMI I SHËRBIMEVE, DHE EFIÇENCA E ENERGIJË

Strategjitë e zhvillimit të komunave në të shkuarën, kishin prirjen t'i trajtonin çështjet e mjedisit si 'shtojca' të strategjive, pa u kushtuar vëmendjen që këto kanë sot. Ky vlerësim strategjik mjedisor vlerëson tendencën e strategjisë së planit për të marrë parasysh ndikimet e prodhimit urban dhe konsumit përtej kufinjve të zonës urbane, minimizimin e ndikimit mbi pyjet, lumenjtë, biodiversitetin, ndryshimin e klimës, etj. Është e rëndësishme që plani të marrë në konsideratë çështje dhe formulojë strategji specifike në tri fusha për të përmirësuar performancën mjedisore:

- Cilësia e mjedisit
- Cilësia e ofrimit të shërbimeve
- Efiçenca e energjisë

Ndotja e mjedisit në përgjithësi përkeqësohet me industrializimin dhe shpesh është në nivelin e tij më të keq gjatë fazave të hershme të industrializimit. Kushtet e mjedisit përmirësohen si pasojë e iniciativave të ndërmara në përgjigje të kërkesave të qytetarëve. Rritja në mënyrë masive e qarkullimit rrugor, burimi kryesor i ndotjes së arjrit në qytet, po ndodh gjithnjë e më shumë në fazën e hershme të trajektorës së zhvillimit. Duke qenë se deri në vitin 2032, Fushë Kosova ka tendencë të ketë një bilanc pozitiv të popullsisë,



dhe kjo ndikon në trajektoren e urbanizimit, strategjia duhet theksuar nevojat bazë për burime njerëzore dhe kapital për ofrimin e shërbimeve elementare. Gjithashtu konsumi energjisë për banorë ka tendencë të rritet, gjë që, me aplikimin e politikave proaktive që inkurajojnë efikasitetin e energjisë, konsumi i energjisë pritet të ketë rënie.

Lidhur me këto tri fusha, me theks të veçantë cilësia e mjedisit, përcaktohen kritere të cilat duhen respektuar me qëllim ruajtjen e mjedisit të komunës.

Kritere të forta mjedisore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal, të cilat i kemi ndarë në (i) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura të natyrës), (ii) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (iii) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore.

(I) Zonat me vlera të veçanta mjedisore përfshijnë:

- Zona e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve (Ligatina e Hencit-Radevës);
- Lokaliteti i Boshtres “*Forsythia Europaea*” (Monument natyror me karakter botanik);
- Pishat e Sllatinës

Nuk lejohen ndërtimet në zonat e mësipërme që bartin vlera të veçanta mjedisore.

(II) Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Shtretërit e lumenjve dhe zonat buferike rreth tyre
- Basenet nëntokësore ujëmbajtëse;
- Toka bujqësore me potencial të lartë;
- Zonat me pjerrësi më të madhe së 15 apo 20%.

Nuk lejohen ndërtimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmytjeve (qoftë dhe shumë të rralla), mund të shkaktojnë erozion të brigjeve, si dhe të cenojnë regjimin hidrologjik të sistemit ujor.

Tokat bujqësore janë të rëndësishme për prodhimin bujqësor dhe si të tilla, ndërhyrjet e paplanifikuara dhe praktikatat bujqësore jo-të qëndrueshme rrezikojnë të shkaktojnë ndotje të rënda të burimeve ujore nëntokësore dhe degradimin e tokës.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndërtimet në zonat me pjerrësi të madhe pasi në mjedis argjilore këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqesojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Plani përmban “hartën e planifikuar për mbrojtjen nga rreziqet natyrore”.

(III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore përfshijnë:

- Deponitë e egra përgjatë lumenjve;
- Zonat pranë termocentraleve, si miniera sipërfaqësore në Bardh të Madh;
- Deponitë e hirit bashkë me deponitë ilegale;
- Deponitë e veturave “varrezat e veturave”.

Të dhënat tregojnë për numër të madh të objekteve industriale, si dhe praninë e shpërndarësve të karburanteve dhe vajrave, gjë që tregon për një ndikim të konsiderueshëm potencial në mjedis. Momentalisht, nuk mund të konkludohet nëse objekte të tilla përbëjnë hot-spot mjedisor bazuar vetëm në të dhënat për praninë e tyre. Këto zona duhet të jenë objekt studimi dhe vlerësimi i hollësishëm, duke përfshirë analizën e niveleve të ndotjes në ujë dhe në tokë, potencialeve të rrezikut për shëndetin publik

dhe biodiversitetin, burimet natyrore, si dhe ofrimin e masave eventuale që duhën ndërmarrë për rehabilitim.

8. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

8.1. METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E SHKALLËS SË NDIKIMEVE

Për parashikimin e karakteristikave të shkallës së ndikimeve, janë përdorur metoda të ndryshme, duke përfshirë vëzhgimet e thjeshta, ilustrime fizike, informacione sasiore, etj. Identifikimi i ndikimeve mjedisore është zhvilluar përmes metodave që përfshijnë listat e kontrollit, matricat, rrjetet dhe diagrama, GIS dhe gjykime profesionale.

Para përshkrimit të ndikimeve në mjedis, janë analizuar të gjitha zhvillimet e planifikuara sipas planit. Gjatë hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës, me theks të veçantë janë përfshirë këta komponentë mjedisorë:

IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE/NDRYSHIMEVE PËR ELEMENTET E MËPOSHTME:		
Uji	Sipërfaqësor	Shkarkime të substancave toksike, inorganike, organike, etj
	Nëntokësor	Filtrime drejt ujërave nëntokësorë
Ajri		Emetimet në ajër që ndikojnë në cilësinë e ajrit
Klima		Emetimet e gazrave me efekt serrë
Toka		Erozioni dhe sedimentimi
Zhurmat		Emetimet e mundshme të zhurmës
Flora, fauna, habitat		Ndikimet e zhvillimeve të propozuara mbi florën, faunën dhe çrregullimin e habitateve
Peizazhi		Ndryshime thelbësore të formës së përdorimit të tokës p.sh. shpyllëzim, urbanizim, etj.
Mbeturinat		Depozitimi, djegia dhe riciklimi
Vlera të trashëgimisë natyrore e kulturore		Asete të cilat mund të dëmtohen nga aktivitetet e propozuara

Tabela 11 Komponentët mjedisorë të parapara në raportin e VSM

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore të Planit Zhvillimor Komunal për Fushë Kosovën është realizuar në përputhje me qasjet e rekomanduara ndërkombëtarisht për vlerësimin strategjik mjedisor. Për të arritur këtë, është përdorur një metodologji që synon të identifikojë, analizojë, dhe vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore të zhvillimeve të propozuara në plan.

8.2. PËRCAKTIMI I INDIKATORËVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT

Indikatorët mjedisorë janë përcaktuar për të vlerësuar ndikimet e ndryshme të zhvillimeve të planifikuara në tokë, ujë, ajër, biodiversitet, klimë, mbeturina, zhurmë, peizazh, dhe trashëgimi kulturore. Për secilin indikatorë, janë përdorur kriteret e vlerësimit si mëposhtë:

- **A** – Pa ndikim/ndikim pozitiv: Zhvillimet e planifikuara nuk kanë ndikim negativ ose kontribuojnë pozitivisht ndaj qëllimeve mjedisore.
- **B** – Ndikim i parëndësishëm: Ndikimet janë të vogla dhe nuk pritet të kenë efekte të ndjeshme afatgjate.
- **C** – Ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Ndikimet potencialisht negative mund të zbuten efektivisht përmes zbatimit të masave të përshtatshme.
- **D** – Ndikim i rëndësishëm: Ndikimet janë të mëdha dhe mund të kenë efekte të konsiderueshme negative mjedisore që kërkojnë veprime të mëtejshme për menaxhimin e tyre.
- **E** – Ndikim shkatërrues: Ndikimet janë aq të mëdha sa që mund të dëmtojnë seriozisht mjedisin ose të çënojnë qëndrueshmërinë e zonave të caktuara.
- **X** – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Nuk ka mjaftueshëm të dhëna për të bërë një vlerësim të qartë ose ndikimi është shumë kompleks për të vlerësuar në këtë fazë.

Indikatori	Zhvillimi i planifikuar	Përshkrimi i ndikimit	Shkalla e vlerësimit	
Uji	Infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimeve	Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit do të përmirësojë cilësinë e ujit dhe menaxhimin e ujërave të ndotura.	A/B	Rritja e efikasitetit dhe sigurisë së furnizimit me ujë për përdoruesit.
Ajri	Infrastruktura dhe industrializimi	Emisionet e ndotësve nga ndërtimi dhe operacionet industriale.	D/E	Ndërhyrje për reduktimin e emisioneve dhe zbatimi i teknologjive më të pastërta.
Klima	Përshtatje e infrastrukturës për të përballuar ngjarje ekstreme meteorologjike	Përmirësimi i kapaciteteve të komunitetit për të menaxhuar ndryshimet klimatike.	B/C	Zbatimi i masave për përshtatje dhe mitigim të ndryshimeve klimatike.
Toka	Zhvillimi urban dhe rural, përfshirë zonat e reja rezidenciale dhe industriale.	Ndikimi në përdorimin e tokës për banim, industri dhe bujqësi. Intensifikimi i ndërtimit dhe zonat e reja të zhvillimit.	C/D	Potencial për fragmentimin e habitateve dhe ndryshimin e peizazhit natyror. Përdorimi i tokës në mënyrë të



				qëndrueshme dhe efikase.
Zhurmat	Aktivitetet e ndërtimit dhe operacionale	Ndotja akustike që rrjedh nga ndërtimi dhe operacionet e mëdha industriale.	D	Implementimi i masave për zbutjen e niveleve shqetësuese të zhurmës përmes dizajnit dhe teknikave të ndërtimit.
Flora, fauna, habitat	Ruajtja dhe zhvillimi i zonave të gjelbra dhe zonave rurale	Ruajtja e biodiversitetit përmes menaxhimit të qëndrueshëm të zonave të gjelbra dhe rurale.	A/B	Mbrojtja e specieve dhe habitateve natyrore, integrimi i masave të ruajtjes në planifikimin e zhvillimit. Masa mbrojtëse dhe kompensuese për ruajtjen e biodiversitetit.
Peizazhi	Urbanizimi dhe zgjerimi i zonave industriale.	Ndikimi i urbanizimit dhe zgjerimit industrial në peizazhet natyrore.	B/D	Planifikimi i hollësishëm për të minimizuar ndikimin vizual dhe ekologjik.
Mbeturinat	Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe operacionet industriale.	Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave dhe infrastrukturës së riciklimit.	A/B	Zvogëlimi i mbeturinave dhe përmirësimi i riciklimit dhe trajtimit të mbeturinave.
Trashëgimia natyrore e kulturore	Ruajtja dhe promovimi i aseteve kulturore në zonat e ndikuar nga zhvillimet.	Mbrojtja e aseteve kulturore nga ndikimet negative të zhvillimit.	A/B	Implementimi i strategjive për mbrojtjen dhe integrimin e vlerave kulturore në planifikimin urban.

Tabela 12 Analiza e shkallës së ndikimit në komponentët mjedisorë

Tabela 13 përdor indikatorë dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuar për të përshkruar se aspekti i zhvillimeve të propozuara mund të ndikojë në mjedisin, dhe si mund të menaxhohen këto ndikime përmes zbatimit të masave të përshtatshme zbutëse.

Sipas këtyre rezultateve, shihet që ndikimet pozitive mbizotërojnë në shumicën e komponentëve mjedisorë. Ndikimet më pozitive janë në komponentët e ujit, florës dhe faunës, mbeturinave, dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Megjithatë, ka edhe ndikime të rëndësishme negative, veçanërisht në komponentën e ajrit. Kjo tregon që strategjitë e mitigimit dhe zbutjes duhet të synojnë përmirësimin e menaxhimit të ajrit dhe ndotjes që ai pëson.

8.3. NIVELI I PËRPUTHSHMËRISË MJEDISORE TË OBJEKTIVAVE TË PLANIT NË FUNKSION TË OBJEKTIVAVE MJEDISORE (OM)



Fushat tematike	Objektivat mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	OM10
	Qëllimet e PZHK	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Nd. klimatike	Trashëgimi Natyrore dhe Kulturore	Shëndeti	Social-ekonomik
ZHVILLIMI EKONOMIK	Q1	-	-	-	- / -	-	-	+	-	+	++
	Q2	-	-	- / -	- / -	-	-	+	+/-	+/-	++
	Q4	+	++	+	++	++	++	+	++	+	+
	Q6	+	+/-	+	+/-	0	+	++	+/-	+/-	++
	Q7	0	0	+	++	++	++	+	+	+	+
	Q8	+	0	0	0	0	0	++	0	+	++
	Q9	+	+	+	+	+	+	+	+	+	++
INFRASTRUKTURA TEKNIKE	Rrjeti i Ujësllësit dhe Kanalizimit										
	Q1	0	++	+	+	0	0	+	0	++	++
	Q2	0	++	+	+	0	0	+	0	++	++
	Energjia Elektrike										
	Q1	++	+	0	0	0	0	++	0	++	++
	Q2	+	0	0	+	0	0	+	0	+	+
	Energjia e Ngrohjes										
	Q1	+	0	0	0	0	0	++	0	++	++
	Grumbullimi dhe Menaxhimi i Mbeturinave										
	Q1	++	++	++	+	+	+	++	+	++	++
INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	Infrastruktura e Transportit dhe Transporti										
	Q1-Q7	++	+	+	++	+	++	++	+	++	++
	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale										
	Q1	+	0	+	0	0	0	+	0	++	++
	Arsimi										
	Q1	0	0	+	0	0	0	+	0	+	++
	Kulturë, Rini dhe Sport										
	Q1	0	0	+	0	0	0	+	+	0	++
	Hapësira Publike										
	Q1	0	+	-	0	0	0	0	0	0	+
MIJESI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI	Q2	+	+	++	++	+	++	+	+	++	++
	Q3	+	+	++	++	+	++	+	+	++	++
	Q1	0	++	+	+	0	0	+	+	++	++
	Q2	++	0	0	0	0	0	++	0	++	++
	Q3	0	0	++	+	+	+	+	0	++	++
	Q4	0	0	0	0	0	0	+	0	+	+
TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE	Q5	+	+	+	0	0	+	+	0	+	++
	Q6	0	0	0	++	++	++	+	++	+	++
VENDBANIMET	Q1	0	0	+	++	+	++	+	++	+	++
	Q2	+	+	++	+	+	+	+	0	+	++
VENDBANIMET JOFORMALE	Q1	+	+	++	+	0	+	+	+	++	++
	Q2	+	+	++	+	0	+	+	0	++	++
SHFRYTËZIMI I TOKËS	Ndërtimet pa Leje										
	Q1	+	+	++	+	0	+	+	0	++	++
	Q2	+	+	++	+	0	+	+	0	++	++
	Q3	++	+	+	0	0	0	++	0	+	++
	Q4	0	0	++	++	0	++	+	++	+	+
	Q5	+	+	++	+	+	+	+	0	+	++
	Q6	+	+	++	++	++	+	+	0	+	+
	Q7	+	++	++	+	0	+	+	0	+	+
	Q8	+	+	++	++	0	++	+	0	+	++
	Q9	+/-	+/-	+/-	0	0	+/-	+/-	0	+/-	++

Tabela 13 Tabela e përputhshmërisë mjedisore të objektivave të planit bë funksion të OM

Sqarim:

++	Përputhshmëri në nivel të konsiderueshëm;
+	Përputhshmëri e knaqshme;
0	Nuk ka efekt;
-	Konflikt i vogël i mundshëm;
-/-	Konflikt i mundshëm domethënës;
+/-	Elemente të puthshmërisë dhe konfliktit;

Objektivat e planit përpiqen të arrijnë një balancë midis zhvillimit dhe mbrojtjes së mjedisit, por kjo vjen me sfida të ndryshme në përputhshmëri dhe konflikte. Objektivat Q1-Q9 që përfshijnë sektorin e zhvillimit ekonomik, përballojnë sfida në përputhjen e tyre me objektivat mjedisore dhe shpesh paraqesin konflikte të mundshme, veçanërisht kur lidhen me ndikimin në ajër, ujë dhe biodiversitet. Nga ana tjetër, objektivat tjera që adresojnë zhvillimin e infrastrukturës, banimit dhe menaxhimin e tokës, ndonëse mund të sjellin përfitime të qarta socio-ekonomike dhe mjedisore, gjithashtu kërkojnë zbatimin e masave mitiguese për të parandaluar ndikime negative mjedisore. Përpjekjet për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve, si energjia e rinovueshme dhe mbrojtja e peizazheve natyrore, janë në përputhje të konsiderueshme me objektivat mjedisore. Sidoqoftë, planifikimi për zhvillimin e zonave të reja urbane ose rurale, siç janë ato në objektivat e mëvonshme, duhet të përfshijë strategji të kujdesshme për të menaxhuar rreziqet dhe për të siguruar që ndërhyrjet të jenë të qëndrueshme. Në tërësi, plani përcakton një drejtim të qartë drejt një zhvillimi të kontrolluar që synon të minimizojë konfliktet mjedisore dhe të mbështesë një jetë të shëndetshme për komunitetin, duke ruajtur gjithashtu vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

8.3.1. Efektet kumulative

Efektet kumulative i referohen ndikimeve të kombinuara të planit në mjedis me kalimin e kohës, duke marrë parasysh ndërveprimet e tyre dhe çdo sinergji ose kompromis. Në kontekstin e VSM-së, është e rëndësishme të merren parasysh efektet kumulative sepse projektet individuale mund të kenë ndikime minimale në vetvete, por kur kombinohen me projekte ose aktivitete të tjera, efektet kumulative mund të jenë të rëndësishme. Kjo mund të rezultojë në degradimin e mjedisit dhe përkeqësimin e cilësisë së jetës për komunitetin.

Për qëllime vlerësimi të mëtejme, do të konsiderohen prioritetet strategjike të planit, të cilat potencialisht mund të kenë ndikim në mjedis.

Elementet që vlerësohen	Zhvillimi i infrastrukturës së transportit	Zhvillimi urban dhe zgjerimi i zonave industriale	Menaxhimi dhe përmirësimi i shërbimeve publike dhe sociale	Ruajtja e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura	Projektet e ndërtimit dhe zgjerimit të infrastrukturës publike	Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë	Promovimi dhe ruajtja e aseteve kulturore dhe natyrore
Uji	C	C	B	A	C	B	A
Ajri	D	E	B	A	D	B	A
Klima	B	C	A	A	B	B	A
Toka	D	D	B	A	C	C	A
Zhurma	D	D	B	A	D	C	A
Flora/Fauna	C	C	A	A	C	B	A
Mbeturinat	B	B	A	A	B	C	A
Trashëgimia natyrore e kulturore	B	B	A	A	B	B	A

Tabela 14 Analizë matricore e efekteve kumulative të elementeve të PZHK-së

9. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

9.1. KONCEPTET ZHVILLIMORE TË PËRDORIMIT TË TOKËS, QASJA POLICENTRIKE

Në analizën e vendbanimeve është vërejtur se në Fushë Kosovë, si në çdo vendbanim tjetër në Kosovë, kemi problem me shtrirjen disperse (objekte të shpërndara) të ndërtimeve, të cilat më tej paraqesin probleme në ofrimin e infrastrukturës dhe elementeve të tjera urbane. Cilësohet si problem me përmasa serioze zgjerimi i tokës ndërtimore në mënyrë spontane, pastaj shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore.

Qasja policentrike kërkon ndërtimin e infrastrukturës shtesë dhe shërbimeve në zonat e reja, krijimin e qendrave të reja të komunitetit bashkë me zonat e gjelbra, hapësira të mjaftueshme publike dhe ofrimin e aksesit në shërbime dhe transport. Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës tregon destinimin e përdorimit të tokës deri më 2032, ku përcakton gjithashtu kufinj të ndërtimor dhe zhvillime të tjera, me ç'rast ndalohen zgjerimet në zonat e gjelbërta dhe peizazhet me interes të veçantë ekologjik dhe të biodiversitetit. Në raste të jashtëzakonshme, kur hapësira të caktuara preken nga zhvillimet e nevojshme, është shumë e rëndësishme rikompensimi përmes krijimit të parqeve të reja dhe hapësirave rekreative në zona të tjera. Zgjerimet e planifikuara prekin zonat rurale dhe humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht sigurojnë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës pjellore, tokës së pasur me resurse

dhe zonave pyjore. Gjithashtu ato janë potencial i fragmentimit të habitateve dhe ndryshimeve në peizazhin natyror, për të cilin qëllim planifikimi i parqeve të reja, korridoreve të gjelbra dhe zonave të tjera rekreative siguron habitatet për botën e gjallë dhe njëkohësisht garanton qasje të barabartë në hapësira të hapura publike për banorët e komunës.

Konceptet e zgjerimit të vendbanimeve mundësojnë shfrytëzim racional të tokës, rritje të dendësisë së banimit, e cila do të arrihet edhe me shfrytëzimin racional të zbrazëtirave brenda zonave të ndërtuara, që rrjedhimisht do të ndikonte në zhvillimin e infrastrukturës, uljen e kostos për investime në infrastrukturë, si dhe qasjen më të lehtë të banorëve në këtë sistem, ndërsa në anën tjetër do të zvogëlon rrezet e shërbimeve tjera si: shkolla, institucione shëndetësore, administratë etj. Zhvillimi kompakt i paraparë për vendbanime do të kursej tokën nga ndërtimet e pa kontrolluara, ndërsa në këtë kontekst vendbanimet shndërrohen në zona funksionale, ku duhet vepruar në konsolidimin e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e asaj që mungon.

9.2. NDRYSHIMET NË KLIMË

Masat e përfshira në VSM për adresimin e sfidave që lidhen me ndryshimin e klimës dhe ndotjen e ajrit, uljen e pasigurive në këto çështje, përfshijnë masa drejt përmirësimit të informacionit (shkencor, ekonomik dhe social), parashikimin e veçorive të ndryshme të atmosferës dhe ekosistemeve të prekura si dhe ndikimet shëndetësore dhe ndërveprimet e tyre me faktorët socio-ekonomikë.

Shqetësimi për ndryshimin e klimës, ndotjen e ajrit, ka sjellë kërkesa për informacion shkencor, ekonomik dhe social për të reduktuar pasiguritë në këto fusha. Qeverisja lokale, në bashkëpunim me organe përkatëse, organizata ndërqeveritare dhe joqeveritare apo edhe sektori privat, duhen nxitur hulumtimin në proceset natyrore që ndikojnë dhe ndikohen nga atmosfera, duke studiuar lidhjet midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndryshimeve të atmosferës. Bashkëpunimet janë të nevojshme për të zhvilluar sistemet e zbulimit të hershëm të ndryshimeve dhe eventeve potenciale, dhe parashikimin e ndryshimeve për vlerësimin e dëmeve mjedisore, sociale dhe ekonomike që ato mund të shkaktojnë.

Janë të nevojshme hulumtimet në zhvillimin e metodologjive për identifikimin e niveleve të pragut të ndotësve atmosferikë dhe përqendrimet e gazrave serrë, të cilat do të trajtohen tek seksioni i cilësisë së ajrit.

9.3. CILËSIA E AJRIT

Në Planin Zhvillimor Komunal, cilësia e ajrit trajtohen me një analizë gjithëpërfshirëse me synimin të identifikojë burimet kryesore të ndotjes, vlerësim të tendencave aktuale dhe historike të ndotjes së ajrit me bazë në të dhëna të grumbulluara nga stacionet më të afërta monitoruese, në Kryshefc dhe Prishtinë-IHMK, si dhe nga një analizë e modeleve nga IHMK. Përgjatë viteve të fundit, në komunë, ka pasur një tendencë të lehtë rritjeje të niveleve të ndotësve të ajrit si PM10, PM2.5, dioksidi i azotit (NO₂) dhe ozoni (O₃), rritje e cila tregon për përkeqësim gradual që kërkon vëmendje dhe veprime të menjëhershme për të zbutur ndikimet.



Duhet theksuar nevoja për instalimin e infrastrukturës lokale të monitorimit të cilësisë së ajrit, për të pasur një bazë të dhënash të sakta dhe marrjen e masave të nevojshme bazuar në informacion më të besueshëm. Ndotës specifikë si PM10, PM2.5 shpesh tejkalojnë standardet e përcaktuara në periudha të caktuara, sidomos gjatë muajve të ftohtë kur kushtet meteorologjike janë të pafavorshme për shpërndarjen e ndotësve dhe rritjen e emetimeve nga djegia e lëndëve djegëse për ngrohje. Të dhënat e mbledhura gjithashtu tregojnë se ka pasur rritje të niveleve të NO₂, veçanërisht pranë stacionit Prishtinë-IHMK, ku nivelet e regjistruara shpesh tejkalojnë pragjet e përcaktuara për mbrojtjen e vegjetacionit dhe shëndetit publik. Zbatimi i monitorimit të cilësisë së ajrit në kohë reale nëpërmjet identifikimit të zonave specifike (zonat me rrezik të lartë, përfshirë zonat me trafik të lartë dhe zonat industriale) brenda zonës urbane për vendosjen e stacioneve të monitorimit do të ofrojë të dhëna të sakta që mund të përdoren për të vlerësuar efikasitetin e masave të ndërmarra dhe për të identifikuar burimet kryesore të ndotjes.

Për të adresuar atë që është thënë më lartë, lidhur me përmirësimin e informacionit, sa i përket cilësisë së ajrit, zhvillimi i një studimi të veçantë për identifikimin e burimeve të grimcave PM është një hap drejt një strategjie efektive të menaxhimit të cilësisë së ajrit. Ky studim duhet të përfshijë analiza të thelluara që do të ndihmojnë në përcaktimin e origjinës dhe trajekteve të ndotësve kryesorë si grimcat PM10 dhe PM2.5. Rezultatet e këtij studimi do të jenë thelbësore për hartimin e rregulloreve të reja që synojnë të kontrollojnë dhe minimizojnë emetimet e këtyre ndotësve në mjedis.

Ngritja e hapësirave të gjelbra në shkallë qyteti (parqet, drunjtë në rrugë, etj.) dhe lagjeje (parqet e vogla, kopshtet e komunitetit, lulishtet, etj.), gjithashtu është një qasje tjetër e nevojshme, për nga përfitimet që sjellin, ekonomike, mjedisore dhe sociale.

9.3.1. Përfitimet nga hapësirat e gjelbra urbane

Përfitime ekonomike: Rritje e vlerës së pronës dhe truallit, ulje e kostos së energjisë (ngrohje-ventilim);

Përfitime mjedisore: Përmirësim i cilësisë së ajrit, reduktimi i rrjedhës sipërfaqësore të reshjeve, erozionit të tokës, përmirësimi i cilësisë së ujit, mbrojtja dhe krijimi i habitateve për botën e gjallë, krijimi i buffer zonave (zonave mbrojtëse), reduktim i niveleve të zhurmës, absorbimi i ndotësve të ajrit, rritja e biodiversitetit urban siguron habitat, ushqim dhe mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve, etj.;

Përfitime sociale: Përmirësojnë shëndetin fizik dhe mendor, rritje e mundësive për rekreacion; mundësi për aktivitet fizik, çiklizëm, vrapim, shëtitje, etj., zbutja e sëmundjeve respiratore, ndikojnë në rritjen e ndjenjës së pronësisë, stabiliteti i lagjeve, reduktimi i niveleve të zhurmës dhe krijimi i buffer zonave, edukim i hershëm për gjeneratat e reja, etj.

9.4. ENERGJIA E RINOVUESHME

Në përballje me nevojën për qasje të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve, Plani Zhvillimor për Fushë Kosovën parashikon integrimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme, veçanërisht energjisë solare. Duke njohur potencialin e konsiderueshëm për prodhimin e energjisë diellore, plani mbështet ndërtimin e impianteve të mëdha dhe të vogla solare që mund të shërbejnë nga lagjet dhe fshatrat e tëra të njësitë individuale të banimit. Këto projekte dhe masa përfshijnë ndërtimin e impianteve të paneleve solare në zonat e identifikuara sipas projektit të "Vlerësimit të Ripërdorimit të Tokës në Minierat e Kosovës-LURA", të cilat do të ndihmojnë në transformimin e energjisë diellore në energji elektrike dhe potencialisht do të

ndërlidhen me infrastrukturën e ngrohjes.

Ndalimi i përdorimit të lëndëve djegëse për ngrohje në zonat urbane dhe ngritja e një sistemi të centralizuar të ngrohjes përmes kogjenerimit janë veprime të cilat ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së ajrit dhe ofrojnë një alternativë më të qëndrueshme dhe efikase për ngrohjen e hapësirave. Mbështetja teknike dhe ekonomike për ekonomitë familjet për të kryer renovime që përfshijnë izolimin termik të objekteve do të rrisë efikasitetin energjetik dhe do të zvogëlojë konsumin e energjisë. Ofrimi i stimuljeve, si subvencionimet dhe uljet e taksës për përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe instalimin e pajisjeve me efikasitet të lartë, si panelet solare, është gjithashtu një pjesë kyçe e tranzicionit energjetik. Këto stimuj do të nxisin komunitetin lokal dhe bizneset të investojnë në teknologji të gjelbërta, duke kontribuar në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm.

9.5. MBROJTJA E TOKËS

Ndotja e tokës në Planin Zhvillimor të Komunës është trajtuar si një çështje kryesore, duke u fokusuar në sfidat dhe rreziqet mjedisore që paraqiten nga operacionet minerare dhe vendgrumbullimet ilegale të mbetjeve. Planifikimi përfshin masat për monitorimin e ndotjes, zbatimin e rregulloreve për menaxhimin e mbetjeve dhe përmirësimin e praktikave të minierave. Gjithashtu, theksohet nevoja për transparencë dhe përpjekje të shtuara për të kuptuar dhe zbutur nivelet e ndotjes. Për problemet ekzistuese të tokës propozohen masat e mëposhtme:

- Implementimi i një programi të rregullt të vlerësimit të ndikimit në mjedis për të identifikuar dhe menaxhuar pasojat mjedisore të aktiviteteve minerare, përfshirë matjet e niveleve të ndotjes dhe ndikimin në ekosistemet e afërta;
- Zbatimi i projekteve të restaurimit që përshtaten me standardet mjedisore për të rikthyer dhe përmirësuar cilësinë e tokës në zonat e prekura nga minierat. Këto programe fokusohen në rikthimin e biodiversitetit dhe stabilizimin e tokës për të parandaluar erozionin më tej;
- Krijimi i zonave tampon për të ndarë hapësirat e minierave nga zonat e banuara dhe tokat bujqësore, të cilat do të kryejnë funksionin e barrierave për të reduktuar shpërndarjen e ndotësve dhe për të mbrojtur komunitetet dhe ekosistemet lokale;
- Kufizime të qarta për llojet e veprimtarive që lejohen në afërsi të minierave.

Sa i përket nevojës për monitorimin e cilësisë së tokës dhe vlerësimit të shkallës së erozionit, duhet të mirren masa për:

- Përcaktimin e stacioneve të monitorimit në zona kyçe, marrjen e mostrave dhe vlerësimin e cilësisë së tokës në mënyrë të vazhdueshme;
- Implementimi i programeve të vazhdueshme që monitorojnë dhe raportojnë për cilësinë e tokës;
- Kryerja e studimeve të hollësishme për të vlerësuar shkallën dhe rrezikun e erozionit në stacionet e monitorimit.

9.6. MBROJTJA E RESURSEVE UJORE

Ndotja e ujit është trajtuar sipas një analize të përgjithshme të problemeve dhe sfidave të cilësisë së ujit në lumenjtë e Komunës. Janë identifikuar burimet kryesore të ndotjes përfshirë këtu ujërat e zeza urbane, shkarkimet industriale dhe ujërat e minierave dhe ndikimin e tyre në cilësinë e lumenjve si Sitnica dhe Prishtevka. Janë vlerësuar nivelet e ndotësve si oksigjeni i tretur, SHBO5, azoti i nitrates, azoti i nitriteve dhe fosfori, për të kuptuar pak a shumë shkallën dhe natyrën e ndotjes. Plani thekson rëndësinë e transparencës në monitorimin e cilësisë së ujit, sigurimin e qasjes në të dhëna mbi cilësinë e ujit.

Për të pasur një qasje të qendrueshme në aspektin e menaxhimit të ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së resurseve ujore, VSM identifikon disa masa të cilat adresojnë shqetësimet aktuale kë këtij sektori. Me qëllim që të kemi një rrjet efikas monitorimi fiziko-kimik, duhet vendosur stacione monitorimi në pika kyçe (aty ku presionet janë më të mëdha), për matjen e parametrave të ndotjes së ujit dhe sigurimin e të dhënave periodike për analizë dhe raportim të rregullt. Në përputhje me nevojën për të mbështetur industrinë në zbatimin e teknologjive të trajtimit të ujërave të ndotura, vlerësimi i buxhetit duhet të përcaktojë një skemë të garanteve të mesme dhe të vogla, si iniciativë që synon të inkurajojë investimet në teknologji që ulin ndotjen dhe përmirësojnë cilësinë e ujit.

Për një vlerësim më të thellë të gjendjes aktuale të trupave ujorë të komunës, hartimi i një plani veprimi nga kompani konsulente ofron një vlerësim të tillë për të adresuar më pas sfidat të cilat identifikohen, rekomandimet specifike dhe vendimmarrjen në të ardhmen. Përcaktimi i zonave të mbrojtura sanitare dhe vendosja e shenjëzimeve garanton mbrojtjen e resursit ujqor nga presionet potenciale ndotëse.

Gjithashtu, duhen paraparë projektet për restaurimin dhe rregullimin e shtratit të lumenjve, mirëpo përtej masave strukturore, projektet e zgjerimi, restaurimit, etj., duhet të kenë për qëllim përmirësimin e kapacitetit natyror të lumenjve për të menaxhuar rrjedhat e ujit dhe reduktuar rrezikun nga përmbytjet, ruajtjen e ekosistemit ujqor dhe natyralizimin e shtratit dhe hapësirave përreth. Restaurimi i shtretërve dhe rigjenerimi i korridoreve lumore duke i natyralizuar ato, rrit biodiversitetin dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Ato funksionojnë si barriera gjatë ngjarjeve të përmbytjeve duke thithur tejmbushjen e ujit pasi ndihmojnë në reduktimin e efektit në drejtim të rrymës, nëpërmjet vegjetacionit natyror. Duke vepruar kështu, specie të ndryshme bimësh dhe kafshësh gjejnë ekosisteme jetike në habitatet e restauruara, të cilat lehtësojnë biodiversitetin dhe shëndetin e ekosistemit.

Rehabilitimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për ujësjellës dhe kanalizim do të adresojë çështjet e kapacitetit dhe do të përmirësojë efikasitetin e menaxhimit të ujërave të ndotura urbane.

9.7. REDUKTIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE

Në kuadër të mbrojtjes dhe minimizimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe ruajtjes së mjedisit, janë identifikuar masa specifike:

- Rehabilitimi i tokave të degraduara ose të kontaminuara përmes teknikave të remedimit;
- Vlerësimi i rrezikshmërisë, përcaktimi i zonave të rrezikuara bashkë me hartimin e planeve të emergjencave dhe sistemeve paralajmëruese;

- Implementimi i metodave si rivegjetimit, ndërtimi i terracave për mbrojtjen dhe stabilizimin e dheut;
- Implementimi i strukturave mbajtëse në lokacionet subjekt i rrëshqitjeve;
- Pastrime periodike të lumenjve (minimum dy herë në vit) për largimin e mbeturinave dhe aluvioneve për të garantuar rrjedhjen e lire të ujit dhe reduktuar rrishtun nga përmbytjet;
- Zbatimi i politikave dhe praktikave që ndalojnë shpyllëzimin e pakontrolluar, promovimi i teknikave të qendrueshme të pylltarisë.

9.8. RRITJA E MBROJTJES, MENAXHIMIT DHE RUAJTJES SË QËNDRUESHME TË TË GJITHA PYJEVE DHE GJELBËRIMI I ZONAVE TË DEGRADUARA

Hartimi dhe zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Biodiversitet, i cili përcakton objektivat dhe strategjitë për ruajtjen e biodiversitetit, dhe përfshin analiza të detajuara të statusit aktual të biodiversitetit, identifikimin e specieve dhe habitateve të rrezikuara, masat për mbrojtjen e tyre. Identifikimi dhe klasifikimi i zonave të reja të natyrës të cilat kanë rëndësi ekologjike të lartë dhe të integrohen në rrjetin e zonave të mbrojtura.

Mirëmbajtja e pyjeve ekzistuese përmes ruajtjes dhe menaxhimit, mbrojtjes, rehabilitimit, rigjenerimit, pyllëzimit, ripyllëzimit dhe mbjelljes së pemëve, me qëllim të ruajtjes dhe rivendosjes së ekuilibrit ekologjik.

Gjithashtu duhen zbatuar strategji dhe teknika për parandalimin e zjarreve, përfshirë këtu kapacitetin për reagim të shpejtë si dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për rrezikun ndaj zjarrit dhe masat preventive.

Gjuetia ilegale është një tjetër problematikë, për të cilën forcimi i masave ligjore dhe zbatimi i operacioneve të rregullta mbikqyrëse është një mjet për luftimin e dëmeve.

9.9. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Në Planin Zhvillimor Komunal, fusha e menaxhimit të mbetjeve është trajtuar si një çështje komplekse dhe sfiduese që kërkon një sërë ndërhyrjesh për të përmirësuar infrastrukturën ekzistuese dhe për të adresuar mungesat në zbatimin e politikave dhe nismave për menaxhimin e mbetjeve.

Fillimisht, problemi i infrastrukturës së pamjaftueshme dhe mungesa e zbatimit të nismave efektive kanë bërë të vështirë jo vetëm grumbullimin dhe transportin, por edhe trajtimin dhe deponimin e duhur të mbetjeve. Kjo çështje është theksuar edhe më shumë nga përpjekjet e kufizuara të komunës për të organizuar shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të vëllimshme dhe të ndërtimit/demolimit, të cilat kanë dështuar për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate dhe sfidave organizative. Prania e deponive ilegale, veçanërisht ato që përmbajnë mbetje nga ndërtim/demolimi, ka ngritur shqetësime serioze mjedisore. Për të adresuar këtë problem, VSM propozon kryerjen e studimeve për të vlerësuar shkallën e ndotjes nga këto deponi dhe organizimin e pastrimit të tyre. Këto studime do të ndihmojnë në hartimin e strategjive për depozitim dhe duhur të mbetjeve në të ardhmen dhe minimizimin e hedhjeve të paligjshme.

Mungesa e të dhënave të sakta dhe të besueshme për sasinë dhe përbërjen e mbetjeve urbane ka bërë të vështirë vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Planifikimi i ri kërkon përmirësimin e metodave të mbledhjes së të dhënave për të siguruar një bazë të fortë informative që do të mbështesë vendimmarrjen e informuar dhe zhvillimin e politikave efektive.

Iniciativat për riciklimin janë të kufizuara dhe mbeten sporadike, kryesisht të kufizuara në projekte pilot që

nuk janë të mjaftueshme për të përballuar sasitë në rritje të mbetjeve që prodhohen në komunë. Planifikimi përfshin nisma për të rritur grumbullimin e ndarë të mbetjeve dhe për të nxitur riciklimin dhe kompostimin si pjesë të një strategjie më të gjërë për reduktimin e mbetjeve.

Masat e propozuara për adresimin e sfidave lidhur me menaxhimin e mbeturinave komunale:

- Implementimi i kontejnerëve për kompostim në zonën urbane;
- Zhvillimi i metodave të sakta për matjen dhe analizimin e mbeturinave përmes mostrave nga kamionët e grumbullimit, për përcaktimin e saktë të sasisë dhe rrymave të mbeturinave;
- Ngritja e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e ndarë të mbeturinave të riciklueshme, të rrezikshme dhe atyre organike; Ngritja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të efektivitetit të programeve për grumbullimin e ndarë të mbeturinave;
- Përgatitja e studimit të fizibilitetit për identifikimin e vendndodhjes së përshtatshme dhe përcaktimin e fizibilitetit të ndërtimit të stacionit transfer;
- Identifikimi i vendeve të përshtatshme për qendrat e kompostimit dhe riciklimit, si dhe siguri i monitorimit dhe mirëmbajtjes së duhur të objekteve të kompostimit;
- Identifikimi i vendeve të hedhjes ilegale dhe hartimi dhe zbatimi i planeve për pastrimin dhe rehabilitimin e këtyre lokacioneve;
- Ngritja e kapaciteteve për inspektim mjedisor;
- Me qëllimin optimizimin e proceseve të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave, duhet bërë vlerësimi dhe funksionalizimi i qendrave të dedikuara për grumbullimin e mbeturinave sipas kategorisë së tyre dhe përcaktimi i itinerareve dhe metodave të grumbullimit të mbetjeve.

10. PLANI I MONITORIMIT

Monitorimi në vetvete, është grumbullimi sistematik, analiza dhe përdorimi i informacionit mbi progresin e një strategjie, plani, programi apo projekti, në një periudhë të caktuar. Ai jep mundësinë për konstatimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre gjatë zbatimit. Bazohet mbi objektivat e caktuara dhe aktivitetet e planifikuara gjatë fazave të planifikimit të procesit, duke ndihmuar në ruajtjen e përqendrimit në kapacitetet dhe kapacitete më të mira të manaxhimit. Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor mandaton autoritetet përgjegjëse të monitorojnë efektet e mundshme mjedisore të secilit plan apo program, me qëllim identifikimin e efekteve të kundërta, të paparashikuara, në një fazë më të hershme, që të mund të ndërmerren veprime të menjëhershme rehabilituese.

Deri më sot, Kosova ka ndjekur përafrimin me standardet mjedisore të BE-së me përparime të rëndësishme në legjislacion në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në tërësi, VNM, VSM, IPPC (International Plant Protection Convention) dhe Mbrojtjen e Natyrës. Mbrojtja e Mjedisit, VSM, VNM dhe Planifikimi Hapësinor grupohen në legjislacionin horizontal dhe transpozimi i legjislacionit të BE-së në sektorin horizontal është i avancuar. Direktiva e VSM 2001/42/EC dhe Direktiva për Pjesëmarrjen Publike 2003/35/EC raportohen si të transpozuara plotësisht. Për sa i përket vlerësimit të ndikimit në mjedis, transpozimi i plotë është arritur në lidhje me dispozitat e Direktivës 2011/92/BE.



Neni 10 i Direktivës së VSM gjithashtu mandaton shtetet anëtare të monitorojnë efektet e rëndësishme mjedisore të zbatimit të planeve dhe programeve në mënyrë që, ndër të tjera, të identifikojnë në një fazë të hershme efektet negative të paparashikuara dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin veprimet e duhura korrigjuese.

Qëllimi i planit të monitorimit është që të sigurojë të dhëna përmes të cilave vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, duke siguruar që aktivitetet e propozuara nuk shkaktojnë nivele të papranueshme të efekteve mjedisore apo rrezik për shëndetin publik. Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve.

Me qëllim që PZHK të zbatohet me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë paraparë me këtë plan, është e domosdoshme që të monitorohet zbatimi i të njëjtit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis. Në mënyrë që zbatimi i planit të monitorimit mjedisor të jetë sa më efektiv, tabela e mëposhtme i referohet objektivave të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit dhe seksionin që trajton ndikimet dhe masat zbutëse. Realizimi me sukses kërkon angazhimin e institucioneve relevante, për bashkërendimin e aktiviteteve përkatëse monitoruese nën drejtimin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Komuna e Fushë Kosovës ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryhen në kuadrin e zbatimit të PZHK-së, ku përfshihen qoftë planet, projektet e infrastrukturës që po hartohen ndërkohë, edhe detajimi i PZHK-së në Plane Rregulluese të Hollësishme për vendbanimet me nënqendra, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Fushë Kosovës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerezore dhe financiare të gjithë këtë veprimtari. Megjithatë, me angazhimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe strukturave të tjera në vartësi të saj, mund të mbulojnë një pjesë të planit të monitorimit si cilësia e ndertimeve, ecurinë me masat e pyllëzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, ecurinë ndërtimit të rrugëve të reja përfshirë ato për qarkullimin me biçikleta dhe të tjerë indikatorë që janë paraqitur në planin e monitorimit të PZHK-së.

Sipas Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, rezultatet e monitorimit duhet të publikohen nga Komuna, në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjerë të mjedisit dhe monitorimin, duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën e VSM, dhe rezultatet t'i përcillen Komunës së Fushë Kosovës dhe AMMK-së. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor t'i publikojë në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.



Receptorët mjedisor	Objektivat Mjedisore	Indikatori	Raporti mi	Institucioni pergjegjes
UJI	Përmirësimi, ruajtja e cilësisë së ujit, zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin, përmirësimi ruajtja e aftësisë për të deponuar ujin, minimizimi i përdorimit të panevojshëm të ujit	Monitorimi i rregullt i parametrave fiziko-kimik të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe ujit të pijshëm, prurjeve, pranisë së ndotësve	6 muaj	Komuna/DSHPM IHMK IKSHPK
AJRI	Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë (p.sh., duke promovuar çiklizmin dhe përmbushja e standardeve të Bashkimit Evropian)	Monitorimi i rregullt i parametrave të cilësisë së ajrit (PM2.5 PM10, NO2, SO2, CO) në komunë, sidomos afër zonave me qarkullim të lartë dhe ato industriale	Vjetor	Komuna/DSHPM AMMK/IHMK
TOKA	Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës, parandalimi i erozionit të tokës, ruajtja e kapacitetit prodhues të tokës (kullosave)	Zvogëlimi i sipërfaqeve që janë subjekt i erozionit dhe degradimit; Nivelet e lëndës organike në tokë; Ndryshimet positive në mbulesën bimore; Vëzhgimi i ndryshimeve në përdorimet e tokës	Vjetor	DBZHR MBPZHR
BIODIVERSITETI	Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, veçanërisht specieve endemike dhe endemorelikte të rralla dhe të kërcënuara	Numri i llojeve të pranishme dhe shpërndarja e grupimeve të llojeve në natyrë; kategorizimi (të rralla, endemike, të kërcënuara); Cilësia dhe madhësia e habitateve natyrore; Shumëllojshmëria biologjike përmes Indekseve të Diversitetit	Vjetor	AMMK
PYJET	Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit pyjor, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike	Sipërfaqja e mbuluar me pyje Shkalla e degradimit	2 vite	DBZHR

PEIZAZHI DHE EKOSISTEMET	Rivitalizimi i ekosistemeve dhe peizazheve të prekura nga aktivitetet njerëzore, ruajtja e karakteristikave të dallueshme të peizazhit dhe pamjeve, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale	Ndërhyrjet në peizazh Ndryshimet në përdorimet e tokës	Vjetor	Komuna/DPU
KLIMA	Ndërtimi i infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike, reduktimi i emetimeve të gazrave serrë duke promovuar mobilitetin urban, çiklizmin dhe ecjen	Emisionet e gazrave serrë; Sipërfaqja e objekteve (m ²) me izolim adekuat; Sipërfaqja (m ²) e paneleve solare të instaluar dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m ²)	Vjetor	Komuna Ministria e Ekonomisë MMPHI
TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE	Konservimi e restaurimi, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale	Statusi i monumenteve dhe hapësirave të mbrojtura dhe restauruara	Vjetor	Komuna/DKRS Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
SHËNDETI	Përmirësimi i shëndetit të popullatës njerëzore, garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore dhe ulja e ekspozimit ndaj rrezikut natyror	Statistikat e sëmundjeve lidhur me ndotjen mjedisore dhe prania e grupeve vulnerabël	Vjetor	Komuna/DSHMS

Tabela 15 Plani i Monitorimit Mjedisor

11. PËRFUNDIME

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i PZHK së Komunës së Fushë Kosovës, ka për qëllim të integrojë sistematikisht çështjet mjedisore. Gjatë implementimit të PZHK si dhe procesit të vendimarrjes, VSM synon të marrë masa plotësuese për projektet të cilat do të realizohen. VSM, si e tillë përkufizohet si:

- Një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendimarrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara;
- Instrument i cili do të sigurojë udhëzime për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve dhe konsideratave mjedisore të PZHK-së;

- VSM do të jep udhëzime për përfshirjen e çështjeve mjedisore në projektet të cilat do të realizohen në të ardhmen;
- Raporti i VSM-së propozon rregullore institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve mjedisore të PZHK-së.

PZHK prezanton një profil, koncept të zhvillimit hapësinor, vizion, prioritetet strategjike, strategji e masa zbatimi. Në PZHK vërehen përpjekje për të orientuar rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa nën-qendra të komunës, bazuar edhe në disa shembuj të përkufizimit të zonave të ndërtimit (jo në definim të zonave në bazë të analizave profesionale) e me qëllim dendësimin në zonat që janë ende në proces zhvillimi dhe kanë synim zgjerimi edhe në zonat e reja të banimit. Zgjerimet e planifikuara marrin parasysh edhe shërbime të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve.

PZHK ka rol përmbajtësor edhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë së ndërtimeve. PZHK, bashkë me sygjerimet që dalin nga VSM, mundohen të ndikojnë pozitivisht në revitalizimin e ekosistemeve të degraduara, ripyllëzimin e zonave të zhveshura, pyllëzimin e disa zonave që vazhdimisht janë në ndikimin e erozionit, etj. Pozitivisht do të ndikojë edhe në ruajtjen e zonave të pasura me ujëra nëntokësore, ekosistemeve të lumenjve nga degradimi dhe nga ndërtimet pranë brigje të lumenjve.

Gjatë përpilimit të raportit të VSM, janë hasur sfida, si mungesa e studimeve në fushën e mjedisit, informata, hulumtime dhe analiza profesionale. PZHK ka definuar disa tregues numerik ose kualitativ për disa pika, vija dhe sipërfaqe të rëndësishme për trajtim adekuat të aspektit mjedisor të planit, vlen të theksohet se në zonat e zhvillimeve të reja të infrastrukturës (korridoret rrugore), zona industriale (sipërfaqja), ndikimi i tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve, masa të duhura për qarkullim natyror të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, zonat me ujëra nëntokësore, zonat me erozion, zonat e deponive dhe të ndotjes, zonat me mundësi pyllëzimi dhe ripyllëzimi, shiritat e gjelbër, tampon zonat, parqet, si dhe janë treguar disa zona të ndotura, për të cilat kanë munguar informatat për tokat e ndotura nga pesticidet apo nivelet e metaleve të rënda. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden edhe në pjesën strategjike. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktikë i synimeve të PZHK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisorë të komunës.

VSM miraton qasjet novatore drejt dekarbonizimit, duke harmonizuar zgjerimin e rrjetit primar të energjisë termike me një inkurajim të fuqishëm për adoptimin e energjisë së rinovueshme në zhvillimet e reja. PZHK nënvizon rëndësinë e diversifikimit të burimeve të energjisë dhe hap pas hapi reduktimin e varësisë ndaj lëndëve djegëse fosile. Theksi vihet në zgjedhjen e përgjegjshme të vendit për projektet e energjisë diellore. Prioritizimi i zonave jo të punueshme bujqësore dhe më pak të ndjeshme siguron përçarje minimale në zonat thelbësore bujqësore dhe ekologjike, duke zbutur kështu konfliktet e mundshme midis infrastrukturës energjetike dhe peizazheve jetike natyrore. Qasja garanton ndikim minimal në rrugët e migrimit të kafshëve të egra dhe korridoret natyrore, duke siguruar lëvizjen e pandërprerë të faunës.



12. LITERATURA

(UNECE), n. N. (1998, June 25). Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters. Aarhus, Denmark.

AMMK. (2022, Gusht). Raport vjetor për gjendjen e mjedisit. Prishtinë.

Kosovës, R. e. (2009, Prill 06). Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Prishtinë.

Kosovës, R. e. (2010, Tetor 29). Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Prishtinë.

Programme, U. N. (2009). Planning Sustainable Cities-Global Report on Human Settlements. London: Earthscan.

Union, E. (2001, June 27). Directive 2001/42/EC on the assessment of the effects of certain plans and programmes on the environment.

Union, E. (2003, May 26). Directive 2003/35/EC for public participation.

Union, E. (2011, December 13). Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment.